⁵⁷ Gjithashtu në çështjen *Plattform “Ärzte für das Leben” v. Austria*, Application No 10126/82, 21 June 1988, para 32, Gjykata nënvizoi që: “Në një demokraci e drejta për të kundër-demonstruar nuk mund të shtrihet në frenimin e ushtrimit të së drejtës për të demonstruar” (përkthyer nga autorët).

me shpejtësi e virusit, pasojat e rënda në shëndetin dhe jetën e njerzve, gjetja e sistemeve shendetësore të papërgatitura për të përballuar pandemi të përmasave të Covid 19, si dhe të panjohurat e shumta lidhur me virusin, kërkonin masa të shpejta. Ndërkohë që në momentet e para të pandemisë ekspertët e kishin te pamundur të vlerësonin efektivitetin e masave që mund të ndermerrnin, shtetet zgjodhën masa drastike si lock doën i vendit, me një sërë kufizime në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Masat e ndermarra vunë në provë edhe demokracitë më të konsoliduara, sa kohë që shteti në çdo kohë duhet të siguronte që masat të ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale e të nevojshme.

Ky punim synon të paraqesë një panoramë të përgjithshme të së drejtës së tubimit në Shqipëri gjatë situatës së pandemisë Covid 19. Pyetja kryesore që ky punim adreson është: nëse dhe deri në çfarë niveli masat e ndërmara nga autoritetet publike janë në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në konventat ndërkombëtare dhe standartet kushtetuese.

Punimi fillon me hyrjen. Seksioni i dytë paraqet një përmbledhje të konventave ndërkombëtare dhe rajonale kryesore që rregullojnë të drejtës për tu mbledhur dhe për të marrë pjesë në tubime paqësore. Seksioni i tretë paraqet një ekzpozë të standarteve kushtetuese mbi lirinë e tubimit dhe kufizimin e saj. Seksioni i katërt diskuton kufizimet e së drejtës së tubimit përgjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19. Seksioni i pestë analizon situatën në Shqipëri duke I dhënë përgjigje pyetjes: nëse masat e marra ligjore janë në përputhje me parimet kushtetuese apo jo? Punimi arrin në konkluzionin që edhe në rrethana të pazakonta si ajo e pandemisë, Kuvendi duhet të luajë një rol më aktiv sa i takon kufizimit të të drejtave të njeriut, duke ushtruar një kontroll parlamentar efektiv

2. E Drejta e tubimit sipas akteve ndërkombëtare dhe rajonale

Liria e tubimit, në shumë konventa ndërkombëtare dhe në legjislacionin e brendshëm është e lidhur ngushtësisht me lirinë e organizimit e cila është e drejta për t'u organizuar me qëllim ndjekjen e objektivave të përbashkëta. Kjo liri përfshin të drejtën për të formuar sindikatat, partitë

politike dhe organet fetare. Në vijim do të paraqesim një panoramë të përgjithshme të akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me lirinë e tubimit. Një rëndësi të veçantë do i kushtohet Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila përbën një burim kryesor të të drejtave të njeriut në legjislacionin shqiptar.

2.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Pas luftës së dytë botërore, Organizata e Kombeve të Bashkuara luajti një rol të rëndësishëm në vendosjen e paqes dhe parandalimin e konflikteve. Në vitin 1946, Kombet e Bashkuara krijuan Komisionin për të Drejtat e Njeriut, i cili u ngarkua me detyrën e draftimit dhe dorëzimit të propozimeve të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar më 10 dhjetor 1948. Edhe pse jo një dokument me vlerë juridike (dokument ligjor), Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ka luajtur një rol të rëndësishëm në frymëzimin e më tepër se 20 instrumenteve standardeve ndërkombëtare dhe rajonale të cilat përbëjnë korpusin e standarteve për mbrojtjen e përgjithshme ose specifike të drejtave të njeriut (Petrela dhe Xhepa 2020, 49 – 50).

Neni 20 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut parashikon:

- “1. Secili ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.*
- 2. Askush nuk mund të detyrohet t'i takojë ndonjë shoqate.”*

Sikurse vërehet, liria e tubimit dhe organizimit parashikohet në dy paragrafë të shkurtër. Paragrafi i parë sanksionon vetëm të drejtën e organizimit dhe tubimit paqësor. Ndërsa në paragrafin e dytë sanksionohet që asnjëri nuk mund të detyrohet që të marrë pjesë në

ndonjë formë të caktuar organizimi a mbledhjeje. Sipas Petrela dhe Xhepa, këto paragrafë kanë kuptimin si vijon: *‘kushdo duhet të ndjehet i lirë në zgjedhjen e vet për t’u organizuar me të tjerë apo jo në shoqata, por pa përfshirë ndonjë hollësi apo shembull se cilat mund të jenë kategoritë e shoqatave dhe kjo lë vend për një interpretim të zgjeruar në praktikë’* (Petrela dhe Xhepa 2020, 51).

Neni 29 (2) përcakton rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat duhet të përcaktohen qartë në ligj me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Kufizimi mund të bëhet vetëm nëse plotësohen kërkesat ‘e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike’ dhe në asnjë rast kufizimi nuk mund të vijë kundër ‘qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara’.⁵⁸

2.2. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon një mbrojtje universale të të drejtave civile dhe politike.⁵⁹ Sipas nenit 2 (1), çdo shtet palë e kësaj Konvente duhet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Konventë pa asnjë dallim bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike sanksionon detyrimin e shteteve që të marrin masat legislative për ta implementuar (neni 2 para 2) dhe parashikon gjithashtu, drejtën e një mjeti juridik efektiv për secilin që mendon që i është shkelur e drejta

⁵⁸ Asambleja e Përgjithshme, ‘Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut’ https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf aksesuar më 1 Maj 2021, neni 29 (3).

⁵⁹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966.

(neni 2 para 3). Deri më tani, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike e kanë ratifikuar 172 shtete.

Në krahasim me regullimin e parashikur nga Deklarata e të Drejtave të Njeriut që parashikon ‘të drejtën e tubimit paqësor dhe organizimit’ në një nen të vetëm, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike i rregullon këto të drejta – liria e tubimit dhe organizimit - në dy nene të ndryshme (Noëak 2005, 483 para 4). Neni 21 rregullon të drejtën e tubimit dhe lexon si në vijim:

“Njihet e drejta e mbledhjes paqësore. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që diktohen sipas ligjit dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, të qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve.”

Sikurse shihet, në krahasim me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Neni 21 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike është më i plotë dhe përmban rastet se kur kjo e drejtë mund të jetë objekt i kufizimeve. Ndërsa e drejta e organizimit parashikohet në nenin 22 dhe lexon si në vijim:

“1. Secili person ka të drejtë të bashkohet lirisht me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar sindikata dhe për të marrë pjesë në to për mbrojtjen e interesave të veta.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizimet ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte nga anëtarët e forcave të armatosura dhe të policisë.

3. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk i autorizon shtetet palë të Konventës së vitit 1948 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës lidhur me lirinë e

bashkimit dhe me mbrojtjen e së drejtës së organizimit për të marrë masa legislative që mund të shkelin ose zbatojnë ligjin në mënyrë që cenojnë garancitë e parashikuara me Konventën e përmendur.”

Neni 21 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike nuk përkufizon se çfarë do të thotë termi ‘tubim’. Sipas Noëak, termi tubim duhet të interpretohet në përputhje me të drejtën zakonore dhe parimet e përgjithshme të së drejtës kombëtare duke marrë në konsideratë objektin dhe qëllimin e kësaj të drejte (Noëak 2005, 484 para 5). Rrjedhimisht, bazuar në qëllimin e së drejtës së tubim, pavarësisht faktit që shtete të ndryshme e e përkufizojnë termin ‘tubim’ në mënyra të ndryshme, konsensusi i përgjithshëm është që interpretimi do të bëhet bazuar në legjislacionin kombëtar të shteteve anëtare dhe praktikës gjyqësore të Komitetit të të Drejtave të Njeriut (Noëak 2005, 484 para 5).

Gjithashtu, siç shihet edhe nga leximi i nenit 21, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike njeh vetëm të drejtën e tubimit paqësor. Termi ‘tubim paqësor’ duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që tubimi mos të ketë trazira apo përdorim armësh. Pra me fjalë të tjera, në tubim të mungojë elementi i dhunës (Noëak 2005, 484 para 10).

2.3. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Pas luftës së dytë botërore, u krijua Këshilli i Evropës, i cili është një ndër organizatat më të rëndësishme rajonale dhe ka për qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit në Evropë. Dokumenti më i rëndësishëm i miratuar nga Këshilli i Evropës është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Qëllimi i miratimit të kësaj konvente ishte që të arrihej një unitet me i madh midis shteteve nënshkruese duke siguruar një njohje universale dhe efektive të të drejtave dhe lirive themelore (Schabas 2015, 484-490). KEDNJ është miratuar nga 47 shtete dhe në të njëjtën kohë përbën si burim i së drejtës në fushën e të drejtave dhe lirive themelore edhe për Bashkimin

Evropian.⁶⁰ Neni 11 i KEDNJ parashikon lirinë e tubimit dhe organizimit dhe lexon si në vijim:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Siç shihet, neni 11 i KEDNJ-së mbron të drejtën e njerëzve për tu grumbulluar në vende publike dhe private, vetën kur qëllimi është tubimi në mënyrë paqësore. Ky është elementi dallues krahasuar me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Në një sërë vendimesh, Gjykata Evropiane e të Drejtave të njeriut ka deklaruar se koncepti i një tubimi paqësor nuk përfshin tubimet ku organizatorët kanë qëllime të dhunshme ose nxisin dhunë.⁶¹

Liria e tubimit garanton pjesëmarrjen e të gjithë personave që të bashkohen, të shprehin, të promovojnë dhe të mbrojnë bashkarisht opinionet e tyre që mund të jenë të karakterit politik, ekonomik, kulturor, social, fetar, etj. Neni 11 përbëhet nga dy paragrafë. Paragrafi i

⁶⁰ Neni 6 (3) i Traktatit të Bashkimit Evropian lexon si më poshtë: ‘Të drejtat themelore, siç garantohen nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe siç rrjedhin nga traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare, përbëjnë parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit.’

⁶¹ *Lashmankin and Others v. Russia*, Applications No 57818/09, para 402; *Stankov and the United Macedonian Organisation Ilinden v. Bulgaria*, Application nos. 29221/95 and 29225/95 2 October 2001, para. 77; *Fáber v. Hungary*, Application No 40721/08, 24 July 2012, para. 37; *Cisse v. France*, Application No 51346/99, 9 April 2002.

parë përshkruan të drejtën e tubimit dhe organizimit; ndërsa paragrafi i dytë paraqet rastet se kur këto të drejta mund të kufizohen. Duhet të theksohet që liritë e sanksionuara në nenin 11 janë ngushtësisht të lidhura me demokracinë që është ‘tipar themelor i rendit publik Evropian’.⁶² Në vendimin *Bączkoński and Others v. Poland*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka nënvizuar që konventa është hartuar më qëllim promovimin dhe ruajtjen e idealeve dhe vlerave të një shoqërie demokratike.⁶³

Liria e tubimit është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike.⁶⁴ Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Moscow Branch of the Salvation Army v. Russia*. Në këtë vendim, gjykata ka njohur të drejtën e tubimit si një ndër liritë themelore pasi ‘pjesëmarrja në procese demokratike, në një masë të madhe, arrihet nëpërmjet përkatësisë së qytetarëve në organizime të cilët ato mund të integrohen me njëri tjetrin dhe të ndjekin qëllime të përbashkëta në mënyrë kolektive’.⁶⁵ Kjo liri përfshin takimet private dhe publike, si dhe tubimet e organizuara në një vend të përcaktuar dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë restriktive.⁶⁶

Sikundër Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, edhe KEDNJ nuk përkufizon termin ‘tubim’, duke ia lënë kompetence përkufizimi legjisllacionit kombëtar. Por, në çështjen *Tatár and Fáber v. Hungary*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka elaboruar një përkuzim autonom duke nënvizuar elementet më të rëndësishme si në vijim:

⁶² *Staatkundig Gereformeerde Partij v. the Netherlands* (dec.), No. 58369/10, § 70, 10 July 2012; *Refah Partisi (the Welfare Party) and Others v. Turkey* [GC], No.41340/98, 41342/98, 41343/98 and 41344/98,.

⁶³ *Bączkowski and Others v. Poland*, No. 1543/06, 3 May 2007, para 61.

⁶⁴ *Djavit An v. Turkey*, No. 20652/92, 20 February 2003, para 56,

⁶⁵ *Moscoë Branch of the Salvation Army v. Russia*, No. 72881/01, 5 october 2006, para 61 (përkthyer nga autorët).

⁶⁶ *Djavit An v. Turkey*, no. 20652/92, 20 February 2003, para 56; *Kudrevičius and others v. Lithuania*, No 37553/05, 15 October 2015, para 91.

“Gjykata konsideron që në kualifikimin e një mbledhjeje të disa njerëzve si një tubim, konsideratë duhet ti kushtohet faktit që një tubim përbën një formë specifike të komunikimit të ideve, ku grumbullimi i një numri të pacaktuar të personave me qëllim të identifikueshëm për të qenë pjesë e procesit komunikues të jetë në vetvete një shprehje intensive e një ideje. Mbështetja për idenë në fjalë shprehet përmes pranisë së një grupi njerëzish, veçanërisht - si në rastin aktual - në një vend të aksesueshëm për publikun e gjerë. Për më tepër, një tubim mund të shërbejë në shkëmbimin e ideve midis folësve dhe pjesëmarrësve, qëllimisht të pranishëm, edhe nëse nuk pajtohen me folësit.”⁶⁷

2.4. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European

Miratimi i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European përbën një hap të rëndësishëm në historinë e Bashkimit European. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European bazohet në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, traditën kushtetuese të shteteve anëtare, konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shtetet anëtare si dhe vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European (EU Charter of Fundamental Rights, Recital 5). Duhet të theksojmë që në fillim, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European u prezantuar si një dokument jo detyrues për shtetet anëtare (2000) dhe vetëm me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës (2009) u inkorporua si pjesë integrale e traktatit në nenin 6 TEU. Arsyeja kryesore e miratimit të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European si një instrument ligjor ishte që të bënte më të dukshme të drejtat ekzistuese, me qëllim respektimin nga institucionet, organet dhe zyrat e Bashkimit European dhe shtetet anëtare (European Council 1999, para 44; Goldsmith 2001, 1216).

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European përmban 54 nene, të ndara në 6 krerë të strukturuar si vijon: Dinjiteti (Nenet 1–5), Liritë (Nenet 6–19), Barazia (Nenet 20–26), Solidariteti (Nenet 27–38) dhe të

⁶⁷ *Tatár and Fáber v. Hungary*, No. 26005/08 and 26160/08, 12 June 2012, para 38.

Drejtat e Shtetasve (Nenet 39–50). Kreu final (Nenet 51–54) trajton rregullat e përgjithshme lidhur me interpretimin dhe qëllimin e Kartës. Karta e të Drejtave themelore të Bashkimit Evropian i adresohet vetëm institucioneve, organeve dhe zyrave të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare vetëm kur zbatojnë legjislacionin e Bashkimit (Neni 51).

E drejta e tubimit dhe e organizimit në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikohet në nenin 12. Ky nen lexon si në vijim:

“E drejta e tubimit dhe e organizimit

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë për tubim paqësor dhe për t’u organizuar në të gjitha nivelet, sidomos për çështjet politike, sindikale dhe qytetare, çka nënkupton të drejtën e secilit për të krijuar dhe për t’u anëtarësuar në sindikata për mbrojtjen e interesave të tij ose saj.

2. Partitë politike në nivel të Bashkimit kontribuojnë për shprehjen e vullnetit politik të shtetasve të tij”.

Në dallim nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të cilat kufizimet i parashikojnë në të njëjtin nen, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon një nen të përgjithshëm për kufizimin e të drejtave të parashikuara. Sipas nenit 52 paragrafi 1 dhe 2 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian:

“Fusha e veprimit dhe interpretimi i të drejtave dhe parimeve

1. Çdo kufizim për ushtrimin e të drejtave dhe lirive që njihen nga kjo Kartë mund të vendoset vetëm me ligj dhe të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Mund të bëhen kufizime, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe nëse në të

vërtetë i përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi apo nevojën për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve.

2. Të drejtat që njihen nga kjo Kartë e që janë parashikuar në Traktatet, ushtrohen sipas kushteve dhe brenda kufizimeve të përcaktuara nga Traktatet.”

3. Standardet kushtetuese mbi lirinë e tubimit dhe kufizimin e saj

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar në vitin 1998 dhe ndryshuar për here të fundit në vitin 2020,⁶⁸ garanton të drejtën e grumbullimit dhe lirinë e tubimit, përkatësisht në nenet 46 dhe 47 të saj, të cilët lexojnë si në vijim:

“Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.
2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.
2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.”

⁶⁸ Ligji 8417/1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’ [1998] GZ 28 ndryshuar me Ligjin 115/2020, Për disa ndryshime në Ligjin Ligji 8417/1998’ [2020] GZ 153 (Kushtetuta e Shqipërisë).

Këto dy të drejta, nuk bëjnë pjesë në kategorinë e të drejtave absolute, për pasojë mund të kufizohen, në përputhje me standardet që ka përcaktuar vetë Kushtetuta. Konkretisht, kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut duhet të përmbushë në mënyrë kumulative kriteret e kufizimit të përcaktuar nga neni 17 i Kushtetutës, sipas të cilit:

“Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Ndërkohë, Kushtetuta parashikon kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore, edhe në kuadër të masave të jashtëzakonshme, të cilat mund të merren për shkak të vendosjes së gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore (Kushtetuta e Shqipërisë, neni 170 para 1).

Për secilën nga këto regjime juridike, Kushtetuta parashikon standardet e kufizimit të të drejtave që mund të aplikohen gjatë ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, si dhe në mënyrë eksplicite dhe shteruese liston të drejtat që nuk mund apo ato që mund të kufizohen përgjatë kohezgjatjes së tyre.

Konkretisht kërkohet që shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, të përcaktohet me ligj, i cili duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të lirisë apo së drejtës (Kushtetuta e Republikës, neni 170 paras 2 dhe 3). Gjithashtu kërkohet që, çdo kufizim që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për

funksionimin normal të shtetit (Kushtetuta e Republikës, neni 170 para 4). Ndërsa për gjendjen e luftës ose gjendjen e jashtëzakonshme Kushtetuta përcakton liritë dhe të drejtat që nuk mund të kufizohen përgjatë ekzistencës së këtyre gjendjeve, për gjendjen e fatkeqësisë natyrore ajo liston të drejtat dhe liritë të cilat mund të gjejnë kufizim (Kushtetuta e Republikës, neni 175).

4. Kufizimet e së drejtës së tubimit përgjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid 19 në Republikën e Shqipërisë

Pandemia e Covid 19 përballi Shqipërinë me nevojën e marrjes së një sërë masash për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Përgjegjësia e shtetit për të garantuar shëndetin dhe jetën e popullsisë, nga virusi, u shoqërua me një sërë masash kufizuese të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta.

Në 11 mars 2020, në po të njëjtën ditë me shpalljen e përhapjes së infeksionit nga Covid 19 si pandemi nga OBSH (Ducharme 2020), Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale nëpërmjet Urdhrit nr. 156/2 shpalli “Gjendjen e epidemisë nga infeksioni Covid 19” në Shqipëri (Urdhër 156/2/2020). Megjithatë, që në datë 8 mars me diagnostikimin e dy rasteve të para në Shqipëri u morën një sërë masash të cilat synonin distancimin fizik të individëve. Nëpërmjet Urdhrit 132/2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, u vendos *“mbyllja e institucioneve arsimore publike dhe jo publike; mbyllja e aktiviteteve publike dhe jopublike si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca; si dhe anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo ta hapura si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike”*. Këto kufizime fillimisht ishin të përkohshme dhe shtrinin efektin deri në datën 3 prill 2020 (Urdhër 132/2020).

Shpallja e gjendjes së epidemisë, u pasua në 15 mars me Aktin Normativ nr. 3 të Këshillit të Ministrave *“Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”* (Akt Normativ 3/2020), i cili me qëllim forcimin e zbatimit të masave të përcaktuara nëpërmjet akteve të nxjerra deri në atë moment parashikoi sanksione të rrepta administrative. Ky akt, ndër të

tjera, parashikoi “...gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjektet apo individët që organizonin zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike” (Akt Normativ 3/2020, neni 3 para 2).

Vetëm në datë 24 mars 2020 me anë të Vendimit 243/2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore” në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, e shoqëruar me kufizimin e një sërë të drejtave kushtetuese. Në kuadër të masave të jashtëzakonshme u vendos: “...detyrimi i organeve publike... të kufizonin aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë; si dhe ndalimi i tubimeve, manifestimeve dhe grevave” (VKM 243/2020, pika 6.1, shkronja “dh”).

Aktet e mësipërme u pasuan nga Urdhri 351/2020 “Për marrjen e masave të vaçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid 19”, në pikën 4 të të cilit parashikohej: “...ndalohen grumbullimet massive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë”.

Ky Urdhër u zëvendësua me Urdhrin 633/2020 “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të hapura dhe të mbyllura”, i cili në pikën 1 të tij urdhëronte: “Të ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë.”

5. Në çfarë mase kufizimet e së drejtës së tubimit përgjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19 në Republikën e Shqipërisë, i përmbahen standardeve ndërkombëtare dhe kushtetuese?

Në këtë pjesë do të analizojmë kushtetueshmërinë e kufizimit të lirisë së tubimit të bërë nëpërmjet akteve të përmendura në seksionin paraardhës. E nisim arsyetimin me VKM 243/2020 e cili shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore. Ky akt del në bazë e zbatim të neneve të Kushtetutës (nenet 170, 174 para 1 dhe 175 para 2) të cituar më sipër, si

dhe Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ky i fundit rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private gjatë emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore (neni 1 I Ligjit 45/2019). Kufizimi i lirisë së tubimit, sipas parashikimeve Kushtetuese, nuk bën pjesë në listën shteruese të të drejtave që kufizohen përgjatë vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ndërkohë, dispozitat e Ligjit 45/2019 (nenet 18 para 1 shkronja “ç”, 19 para 1 dhe 39), nën të njëjtën linjë me Kushtetutën, nuk autorizojnë kufizimin e lirisë së tubimit dhe organizimit gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Për pasojë, në VKM 243/2020 ndalimi i lirisë së tubimit, është në tejkalim të Kushtetutës dhe ligjit të sipërpërmendur.

Në fakt, gjatë kohëzgjatjes së një sëmundje infektive si Covid 19, është Ligji 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” ai që përcakton një regjim juridik specifik duke parashikuar një sërë masash, përfshi dhe kufizime të të drejtave dhe lirive që merren në kuadër të parandalimit të këtyre sëmundjeve. Konkretisht, ky ligj autorizon ministrin përgjegjës për shëndetësinë që, sipas udhëzimeve të përgatitura nga Instituti i Shëndetit Publik, të mund të vendosë masa për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektive, të tilla si mbylljen e shkollave, mbylljen e aktiviteteve jopublike apo publike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, kufizimin apo ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit publik, apo kufizimin e lëvizjeve brenda vendit. Në bazë të këtij autorizimi duhet të mbështeten Urdhrat e ministrit përgjegjës për shëndetësinë, të cilat gjatë kohëzgjatjes së pandemisë vendosën kufizimin e të drejtës së tubimit në Shqipëri (Urdhrat 132/2020, 351/2020 dhe 633/2020).

Për të kuptuar, nëse kufizimi i lirisë së tubimit është në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare, në vijim do të analizojmë nëse urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të cituar më sipër (Urdhri 132/2020, 351/2020 dhe 633/2020) që disponojnë mbi lirinë e tubimit i përmbahen këtyre standardeve. Konkretisht do të analizojmë standardet kushtetuese të vendosura nga neni 17, të cilat zbërthejnë dhe përmbledhin gjithashtu ato të vendosura nga nga aktet

ndërkombëtare të analizuara në seksionin e parë, duke u dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- i. nëse kemi të bëjmë me një kufizim të bërë me ligj
- ii. nëse kufizimi është në mbrojtje të interesit publik ose mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve;
- iii. nëse kufizimi është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, si dhe
- iv. nëse kufizimi nuk çënon thelbin e lirive dhe të të drejtave.

Gjatë analizës sonë do të marrim në shqyrtim edhe vendimin nr.11, datë 9.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shqyrtuar ankimin e Partisë Republikane Shqiptare për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Urdhrit 633/2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pyetja e parë që ngrihet në këtë rast, është: a jemi para një kufizimi të bërë me ligj? Neni 17 përcakton qartë që kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen “*vetëm me ligj*”. Lidhur me kriterin “*vetëm me ligj*”, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se “*një parashikim i tillë referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi*”.⁶⁹ Gjykata vlerëson se: “*çdo interpretim i kundërt, është padyshim një zhvleftësim i garancisë që jep Kushtetuta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe do t'i cenonte efektivisht këto liri e të drejta*”.⁷⁰ Ndërkohë Gjykata Kushtetuese ka qenë shumë strikte dhe nuk ka interpretuar togfjalëshin “*vetëm me ligj*” në favor të asnjë organi tjetër, përfshi këtu dhe Këshillin e Ministrave, sa herë ky i fundit mund të ketë disponuar për kufizime lirish dhe të drejtash, pa pasur një autorizim ligjor konkret ligjor, ose thenë ndryshe në rastet e ‘*rezerves ligjore absolute*’.

Pyetja që është shtruar së fundmi për diskutim nga Gjykata ka qënë nëse jemi brenda standardit të kufizimit “*vetëm me ligj*” në rastet kur vetë ligji i miratuar nga Kuvendi ka autorizuar organe të tjera në nxjerrjen e

⁶⁹ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 20/2006.

⁷⁰ Po aty.

një akti që përbën kufizim të drejtash dhe lirish?⁷¹ Pra, nëse në rastin e ‘*rezervës ligjore relative*’ a mjafton që aktet nënligjore ku parashikohet kufizimi i të drejtave, të nxirren në respektim të kriterëve të delegimit të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës? Thënë ndryshe nëse autorizimi i posaçëm ligjor për ndërmarrje aktesh nënligjore dhe fakti që përmbajtja e këtyre të fundit nuk tejkalon autorizimin e dhënë nga ligji janë të mjaftueshme për të përmbushur kriterin “*vetëm me ligj*”. Gjykata Kushtetuese me vendimin 11/2021 ka vlerësuar se sa kohë në rastin konkret kufizimi i lirisë së tubimit është i parashikuar në nenin 7 të Ligjit 15/2016 “*Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive*” dhe ky i fundit autorizon ministrin përgjegjës për shëndetësinë të miratojë me urdhër masa të veçanta për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive, duke përmendur në mënyrë eksplicite si një masë të posaçme “*anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura*”, nuk ka shkelje të kriterit të “*kufizimit me ligj*”, sipas nenit 17 të Kushtetutës⁷². Pa dashur të analizojmë përmbushjen e kriterëve të përcaktuar nga vetë ligji 15/2016, pasi nuk është qëllimi i punimit, po ndalemi në një nga aspektet që duhet të përmbushë kriteri i kufizimit me ligj, sipas doktrinës dhe jurisprudencës së GJEDNJ.

Kriteri i “*kufizimit me ligj*”, sipas elaborimit të bërë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon ndër të tjera dhe përmbushjen e detyrimit që ligji të jetë i formuluar me fjalë mjaft të qarta dhe të kuptueshme për të mbrojtur individët kundër ndërhyrjeve arbitrare tek e drejta e tyre (Bianku *et.al.* 2020, 108). GJEDNJ në çështjen *Ezelin v France*, ka pranuar se: “*qartësia absolute lidhur me pasojat e veprimeve të njerëzve mund të jetë e pamundur të arrihet, meqenëse ligjet duhet të ruajnë një shkallë fleksibiliteti për të lënë vend për ndryshimin e rrethanave*”.⁷³ Megjithatë, diskrecioni ligjor nuk duhet të jepet në

⁷¹Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 11/2021. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim ankimin ndaj kufizimit të lirisë së tubimit të bërë nga një subjekt politik, nëpërmjet Urdhrit nr. 633/2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

⁷² Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 11/2021, paras 48 dhe 50.

⁷³ *Ezelin v. France*, Application No. 11800/85, para 45.

formën e fuqisë së shpenguar, dhe ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushëveprimin e çdo diskrecioni dhe mënyrën e ushtrimit të tij (Bianku *et.al.* 2020, 108).

Nëse analizojmë dispozitat e Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe Urdhrat respektive të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dale në zbatim të nenit 7 të tij, shohim që qartësia e këtyre të fundit lë për të dëshiruar. Urdhrat 351/2020 dhe 633/2020, bazuar në interpretimin gramatikor, ndalojnë një sërë veprimtarish në mënyrë shteruese, ku tubimi është një prej tyre dhe renditet pas grumbullimeve masive, pra si kategori e veçantë dhe jo në mënyrë ilustrative si një prej tyre.⁷⁴ Ndërkohë, një stil i tillë shkrimi, është ndjekur në urdhrin 132/2020 ku tubimi (për shkak të përdorimit të shprehjes “të tilla si”), tregohet në mënyrë ilustrative si një ndër grumbullimet masive që ndaloheshin.⁷⁵ Referuar mënyrës së shkrimit dhe interpretimit gramatikor e gjyhesor, askush nuk mbetet i qartë dhe i sqaruar nga një lexim i aktit, dhe konkretisht nuk ka një përgjigje ezauruese nëse me Urdhrin 353/2020 ndalohen vetëm tubimet me grumbullime masive njerëzish apo çdo lloj tubimi, pavarësisht numrit/ Gjithashtu, nëse jemi në rastin e parë, cfarë do të konsiderohen “*grumbullime masive*”. Po ashtu, në rastin e Urdhrit 633/2020 nuk është e qartë nëse ndalohen tubimet mbi 10 veta, apo çdo lloj tubimi. Madje dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese 11/2021 gjyqtarët pranojnë këtë paqartësi dhe referuar saj, shprehen se: “si rregull hartimi i akteve nënligjore në mënyrë të shkurtuar dhe të përmbledhur, pa një pjesë hyrëse dhe pa raporte shpjeguese që i

⁷⁴ Urdhri përdor terminologjinë “ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë”.

⁷⁵ Urdhrat përmendin konkretisht: “Ndalohen grumbullimet massive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore”.

“Të ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore”.

*shoqëron ato, e bën më të vështirë vlerësimin nëse një kufizim i veçantë i të drejtave përmbush parimet dhe standardet kushtetuese dhe kjo situatë përkeqësohet kur rregullat ndryshojnë shpesh ose kur qasjet janë ad hoc”.*⁷⁶

Më tej, Gjykata vijon dhe bën një interpretim mbi mënyrën se si duhej të lexohej Urdhri i kundërshtuar:

“Pavarësisht se urdhri i kundërshtuar nuk përmban elementet e cituara më lart, që do të ndihmonin në eliminimin e çdo dyshimi për saktësinë e përmbajtjes së tij, Gjykata çmon se ai duhet kuptuar se lejon grumbullimet e çfarëdo lloji deri në 10 persona, duke përfshirë lejimin e mbledhjeve partiake deri në 10 persona dhe të tubimeve deri në 10 persona.”⁷⁷

Por ky është thjesht një interpretim për mënyrën se si duhet të lexohet akti, që të jetë në përputhje me standardin kushtetues, por që jo detyrimisht reflekton qëllimin e hartuesit, apo mënyrën se si duhet ta zbatonin atë institucionet para se akti të bëhej objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese

Po ashtu, edhe gjyqtarët në analizimin e mendimit të pakicës e pranojnë paqartësinë e urdhrit 633/2020, duke sqaruar që interpretimi i shumicës është interpretim pajtues,⁷⁸ dhe kërkuesit për një kuptim të saktë të urdhrit duhet të ezauronin rrugën administrative, duke iu drejtuar me kërkesë për interpretim Ministrisë së Shëndetësisë.⁷⁹ Për pasojë gjyqtarët e pakicës pranojnë që pala kërkuese “....nuk ka pasur qasje funksionaliste në kuptim të të drejtave dhe lirive të veta”.⁸⁰ Në fakt ky

⁷⁶ Gjykata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 11/2021, para 26.

⁷⁷ Po aty, para 27.

⁷⁸ Po aty, mendim Pakice paras 12 dhe 13.

⁷⁹ Po aty

⁸⁰ Po aty

konstatim i Gjykatës, lidhur me paqartësinë e aktit, përbën shkelje të vetë standardit të qartësisë së ligjit që kërkohet lidhur me kriterin e “kufizimit me ligj” nga Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Qytetari duhet të jetë i qartë për kufizimin e lirisë së bërë dhe nuk mund ta vendosësh atë para detyrimit të kërkojë interpretime nga organi që ka hartuar aktin. Për më tepër, në rastin konkret, në një akt me pak rreshta, kur i paqartë mbetet dhe vetë gjyqtari kushtetues, është mëse evidente se kriteri i qartësisë nuk është i përmbushur. Mundësia për të kërkuar interpretim nga organi që ka nxjerrë aktin nuk mundet kurrësesi të balancojë apo justifikojë paqartësinë e aktit me të cilin është vendosur kufizimi i lirisë apo së drejtës, si dhe mungesën e shpjegimit të tij. Pra, pavarësisht se në rastin e urdhrave mund të jemi në kushtet e “*rezervës relative të ligjit*”, mungesa e qartësisë mendojmë se nuk ofron garancitë e kërkuara për të mbrojtur individët ndaj ndërhyrjeve arbitrare. Aq më tepër kur paqartësia i lë hapësirë të gjerë diskrecionale autoritetit për të vendosur mbi anulimin apo kufizimin e së drejtës së tubimit.

A është vendosur kufizimi në mbrojtje të interesit publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve? Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimet e saj, gjatë interpretimit të kushteve të kufizimit të së drejtës, sipas nenit 17/1 të Kushtetutës, çmon se: “koncepti kushtetues i interesit publik, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj(Gjykatës)”⁸¹. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore”.⁸² Sipas praktikës kushtetuese ndërkombëtare, të konsoliduar tashmë, është pranuar se: “ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë”⁸³.

Në Vendimin 11/2021 të Gjykatës Kushtetuese, në analizimin e kufizimit të lirisë së tubimit të bërë sipas Urdhrit 633/2020, nuk e ka

⁸¹ Gjykata Kushtetuese Shqiptare, Vendimet Nr. 16/2004 dhe Nr. 35/2007.

⁸² Po aty.

⁸³ Gjykata Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane, BVerfGE 76,1.

konsideruar veten kompetente në vlerësimin në aspektin teknik, nëse masat e marra nga autoritetet publike janë të përshtatshme dhe të duhurat, për përballimin e pandemisë.⁸⁴ Por, mbështetur në Dokumentin Informativ të Këshillit të Evropës, për “Respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19” (Këshilli i Evropës 2020), ka rikonfirmuar se *“mbrojtja e shëndetit” është një nga “qëllimet legjitime” që u mundëson qeverive përkatëse të ndër marrin masa kufizuese gjatë parandalimit dhe luftimit të pandemisë përkatëse, sa kohë ato janë të “përcaktuara në ligj” dhe “të domosdoshme në një shoqëri demokratike”*.⁸⁵ Mbi këto arsye Gjkata, në konkluzion, vlerëson se: *“në kufizimin që i ka bërë së drejtës së tubimit, Ministri I Shëndetësisë ka ndjekur një “qëllim legjitim”, përkatësisht atë të “mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga një sëmundje infektive me impakt të madh”, i cili përfshihet në konceptin e interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës”*.⁸⁶

Nga ana tjetër KEDNJ, në nenin 11, pika 2, parashikon si *“qëllime legjitime”*, që justifikojnë kufizimin e të drejtës së tubimit paqësor, sigurinë publike ose sigurinë kombëtare, mbrojtjen e rendit ose parandalimin e krimit, si dhe mbrojtjen e shëndetit, moralit, ose të drejtave dhe lirive të tjerëve. Në linjën e kësaj praktike gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe në mungesën e praktikës gjyqësore edhe Gjkata Kushtetuese e Kosovës ka pranuar që kufizimet në lirinë e lëvizjes si rezultat i pandemisë COVID-19, kanë ndjekur një *“qëllim legjitim”*, konkretisht atë të mbrojtjes së *“shëndetit publik”*, të përcaktuar specifikisht në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.⁸⁷

Megjithatë, pavarësisht lirisë së veprimit që i lë ligjvënësit për interesin publik në përgjithësi, duhet të mbajmë në konsideratë se GJEDNJ në praktikën e saj nuk u lë hapësirë të gjerë veprimi shteteve në anulimin e lirisë së tubimit. Për të justifikuar një ndalim të përgjithshëm, Shteti duhet të demonstrojë që ekziston një rrezik real i cili nuk mund të

⁸⁴ Gjkata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 11/2021, para 55.

⁸⁵ Gjkata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 11/2021, para 54.

⁸⁶ Po aty, para 57.

⁸⁷ Gjkata Kushtetuese e Kosovës, Vendimi KO61/20, para 176.

parandalohet përmes masave të tjera më pak shtrënguese (Bianku *et.al.* 2020, 110). U takon shteteve që të argumentojnë në fakt sa më sipër (ibid).

Sigurisht pajtohem me mbrojtjen e shëndetit si një “qëllim legjitim” i mjaftueshëm për të ndërmarrë kufizimet e lirisë së tubimit. Dhe në Urdhrin 133/2020, kur pandemia e gjeti Shqipërinë si çdo vend tjetër të papërgatitur, të ngerthyer nga paniku, me një sistem shëndetësor të brishtë krahasuar me vendet e tjera, të cilat po kalonin në kolaps, ndalimi i grumbullimeve masive dhe tubimeve, si një prej tyre, ishte mëse legjitim. Megjithatë situata nuk është e njëjtë në gjithë periudhën kur ka ekzistuar ndalimi. Përgjatë saj, “qëllimi i ligjshëm” dhe “interesi publik” për mbrojtjen e shëndetit, fillojnë zhvendosen në peshoren që i balancon ato në raport me të drejtën e tubimit.

Ligji 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, në nenin 7, pika 4, sa kohë parashikon masa të një natyre të përgjithshme për parandalimin e infeksioneve infektive hipotetike bën një përshkrim gjeneralist lidhur te drejtën e ministrit të shëndetësisë për të bërë ndër të tjera edhe “anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”.⁸⁸ Ndërkohë Urdhri i Ministrit, pavarësisht autorizimit ligjor duhet të krijojë në mënyrë të qartë dhe bindshëm besimin se kufizimi i lirisë së tubimit, është pasojë e rrezikimit të jetës së individëve. Kështu, referuar kontekstit të kohës kur u ndërmorën masat shtërnguese, ndalimi i bërë në Urdhrin 132/2020⁸⁹ të Ministrit të Shëndetësisë, sa kohë u mor kur vendi ishte vendosur në karantinë të plotë dhe dalja nga banesa ishte e kufizuar dhe kushtëzohet

⁸⁸ Neni 7, pika 4 lexon: “Për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive që kanë impakt në shëndetin e saj, ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton, me urdhër, masa të veçanta për mbrojtjen nga këto sëmundje, sipas udhëzimeve kombëtare, të përgatitura nga Instituti i Shëndetit Publik si më poshtë: a) mbyllja e shkollave; b) mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike; c) anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura; ç) kufizimi apo ndalimi i lëvizjeve me mjetet e transportit publik; d) kufizimi i lëvizjeve brenda vendit”.

⁸⁹ Ndalim i cili konsistonte në “anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura ose të hapura të tilla si koncerte tubime apo dëgjesa publike”.

kundrejt lejeve, vetëm me nevoja mjekësore ose jetësore, nuk lë shkas për dyshim apo mungesë të *ratio legis* së tij. Ndërkohë nuk mund të thuhet e njëjta gjë për parashikimet e bëra në Urdhrat 351/2020 dhe 633/2020. Koha e marrjes së këtyre urdhrave, korrespondon me periudhën kur vendi kishte dalë nga karantina dhe masat kufizuese ishin lehtësuar. Për këdo mbetet i paqartë ndalimi i tubimit, në raport me shumë veprimtari të tjera të lejuara. Nuk kuptohet përse tubimi në një mjedis të hapur, ku mund të respektohet distanca fizike e rekomanduar nga OBSH prej 1.5-2 m, apo çdo masë tjetër anticovid, është një veprimtari më e rrezikshme për përhapjen e infeksionit, sesa udhëtimi me mjete të transportit publik, pra ambiente të mbyllura me pamundësi ruajtje të distancës?

Madje dhe Gjykata Kushtetuese, lidhur me ndalimin e tubimit të bërë në bazë të Urdhrit 633/2020, megjithëse nuk ka gjetur shkelje, duke mos e konsideruar veten eksperte, ka theksuar nevojën që:

“... autoritetet publike t’i justifikonin publikisht aktet nënligjore, duke dhënë detaje për shkakun, objektin dhe qëllimin, që në një term të vetëm nënkupton “ratio legis”, si dhe duke vënë në dispozicion të publikut informacionin e duhur, i cili mund të sqarojë qytetarët se përse disa veprimtari grupohen së bashku, ndërsa disa të tjera trajtohen ndryshe.”⁹⁰

Kjo, ka qenë arsyeja që Gjykata ka rekomanduar gjithashtu edhe domosdoshmerine e “raportimit periodik përpara legjislativit të autoriteteve publike që marrin këto masa kufizuese si një praktikë tjetër e mirë, që i shërben shtetit të së drejtës, në të cilin pushteti legjislativ, ndër të tjera, kontrollon dhe garanton përgjegjshmërinë e organeve të ekzekutivit”.⁹¹ Në fakt vetë këto rekomandime dhe sugjerime të Gjykatës, nuk bëjnë gjë tjetër veçse shprehin rezervë të saj mbi justifikimin e ndërhyrjes ligjore, e konkretisht mbi “qëllimin e ligjshëm” dhe siç do sqarojmë në vijim të proporcionalitetit të kufizimit të lirisë së tubimit.

⁹⁰ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 11/2021, para 47.

⁹¹ Po aty, para 47.

A ishte kufizimi i lirisë së tubimit në proporcion me gjendjen që e shkaktoi nevojën e kufizimit? Në nenin 17, Kushtetuta kërkon gjithashtu që çdo masë për kufizimin e të drejtave themelore duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë, pa cenuar thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe pa tejkaluar kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Në rastin tonë shtrohet për diskutim pyetja nëse kufizimi i lirisë së tubimit është në një marrëdhënie proporcionale me nevojën për të mbrojtur shëndetin e popullatës. Siç ka pranuar dhe Gjykata Kushtetuese gjatë praktikës së vet:

“në thelb të parimit të proporcionalitetit kërkohet të vlerësohet (i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t’u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.”⁹²

Sigurisht kur bëhet fjalë për shëndetin duket sikur çdo ndërhyrje në të drejta apo liri është mjaftueshëm e rëndësishme dhe legjitime, pra në këtë pikë nuk ka dyshime mbi rëndësinë e objektivit të ligjvënësit.

Sa i takon arsyetimit nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, Gjykata Kushtetuese në vendimin 11/2021 ka vlerësuar se:

“Në kontekstin e rrethanave të pazakonta të krijuara nga pandemia COVID-19, ndalimi i përhapjes së këtij virusi përbën një “nevojë urgjente shoqërore”. Prandaj dhe masat e marra, duke përfshirë edhe urdhrin e ministrit 633/2020 në rastin konkret, janë të lidhura me këtë objektiv, në kuadër të detyrimeve dhe përgjegjësi që kanë autoritetet

⁹² Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimet Nr. 33/2016; 52/2012 dhe 1/2013.

shtetërore për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse.”⁹³

Ky arsyetim është bindës, por a përmbush ndalimi i lirisë së grumbullimit dhe tubimit kriterin e “*të mos qënit arbitrar, i padrejtë*”? A është ai i bazuar mbi vlerësime logjike? Lidhur me këto të fundit, ngrihen disa pikëpyetje.

GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj nuk ka gjetur shkelje të nenit 11 të KEDNJ për kufizimet mbi grumbullimet publike, qoftë për shkak të vendit të mbajtjes, apo numrit të pjesëmarrësve, ku qëllimi ishte mbrojtja e sigurisë publike ose ruajtja e rendit publik, ashtu edhe në rastet kur grumbullimi është shpërndarë për të mbrojtur shëndetin e pjesëmarrësve (Bianku *et.al.* 2020, 109). Por, ndryshe nga kufizimi, nuk ka një praktikë për ndalimin e të drejtës në përgjithësi (ibid). Edhe pse në dukje objektivi i ndalimit të tubimeve është mjaftueshëm i rëndësishëm dhe i lidhur me objektivin, në kushtet kur kemi të bëjmë me një ndalim të përgjithshëm të lirisë së tubimit (të paktën interpretimi gramatikor aty na çon), pa marrë në konsideratë rëndësinë e nevojave për mbajtjen e tubimeve, situata ndryshon. Në këtë rast, masa e marrë, pavarësisht se justifikohet me rekomandimit e një grupi ekspertësh teknikë, nuk duket e drejtë dhe në një linjë logjike me gjithë masat e tjera të ndërmarra. Mbetet e paqartë arsyeja se pse tubimet në vend të hapur, më mundësinë e ruajtjes së distancës sociale, të organizuara në mënyrë sporadike, mund të jenë më të rrezikshme se veprimtaritë e përditshme në mjedise të mbyllura dhe me pamundësi reale për të ruajtur distancimin social. Kjo ishte dhe vetë arsyeja që gjykata shprehu rezervë për vlerësimin dhe kërkoi nevojën e arsytimit dhe shpjegimit të urdhrave të ministrit të shëndetësisë.

Dyshimi shtohet edhe me tej nese i referohemi praktikës së ndjekur nga shtete të ndryshme. Rezulton që këto të fundit kanë marrë masa të ndryshme, ndaj po të njëjtës “*nevojë urgjente shoqërore*” siç ishte pandemia e Covid-19, pavarësisht se ajo nuk preku kudo njësoj dhe pasojat varionin nga shteti në shtet. Pra, mjafton të shohësh shtete si

⁹³ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 11/2021, para 64.

Anglia, ku pandemia megjithëse goditi në përmasa të mëdha, mbajtja e protestave lejohej, madje tubimet bënë një përjashtim nga rasti i grumbullimeve masive (House of Commons and House of Lords 2021). Një qëndrim të balancuar mban dhe Gjermania, ku Gjykata Kushtetuese Gjermane vendosi që kufizimet lidhur me Covid-19 nuk duhet të peshojnë automatikisht më shumë se liria e tubimit (DË 2020). Kjo Gjykatë kërkoi që shteti duhet të shqyrtojë kërkesat për të zhvilluar tubime rast pas rasti, duke mbajtur në konsideratë për të vlerësuar lejimin gadishmërinë e organizatorëve për një numër më të vogël pjesëmarrësish, hapësirën fizike në dispozicion, si dhe vendin dhe kohën e zhvillimit të tyre (DË 2020).

Urdhrat e ministrit në vetvete ndalojnë mbajtjen në çdo rast të tubimeve, pa argumentuar nga ana shkencore rrezikun që vjen për shembull nga një tubim me numër të limituar pjesëmarrësish në ambjent të hapur dhe me distancim fizik, sipas udhëzimeve të OBSH. Nga ana tjetër, situata e pandemisë nxorri në pah nevojën e ndërhyrjes së kujdesshme në të drejta dhe liri si ajo e tubimit dhe e shprehjes, që në fakt janë garantë të shtetit të së drejtës edhe në situata të pazakonta si ajo që kaluam. Kështu siç edhe pranuan disa protestues, në rastin e protestës së Black Lives Matter, kufizimi i lirisë së tubimet përbënte më shumë rrezik për të drejtën e tyre për jetën dhe mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues, sesa rreziku nga përhapja e Covid-19 (Bianku *et.al.* 2020, 112). Si përfundim, mund të themi se anulimi i tubimit, në fakt është më i ashpër sesa duhet për të arritur objektivin e mbrojtjes së shëndetit.

Megjithatë, Gjykata vlerëson se Urdhri 633/2020 nuk respekton kriterin e proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak të mosparashikimit të një afati të përcaktuar për kohëzgjatjen e masave kufizuese dhe për këtë shkak shprehja “*gjer në një urdhër të dytë*” duhet të shfuqizohet.⁹⁴ Kjo, pavarësisht mendimit të pakicës, në fakt çënon parimin e proporcionalitetit, por që në fakt siç argumentuam më sipër, është vetëm një nga cënimet që i bëhet këtij parimi dhe jo i vetmi.

⁹⁴ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 11/2021, para 70.

A çënojnë kufizimet e lirisë së tubimit, thelbin e kësaj lirie? Neni 17 i Kushtetutës kërkon gjithashtu që kufizimi i vendosur me ligj, nuk duhet të çënojë thelbin e lirisë dhe të drejtës. Në fakt, ndalimi i tubimeve (referuar mënyrës së shkrimit dhe interpretimit gramatikor), si dhe kohëzgjatja pa ndalim e kufizimeve nuk bëjnë gjë tjetër veçse çënojnë në thelb lirinë e tubimit. Edhe Gjykata Kushtetuese, lidhur me kohëzgjatjen “*deri në një urdhër të dytë*”, të urdhrave kufizues të Ministrit të Shëndetësisë, ka analizuar se:

“.....si rregull, çdo kufizim i të drejtave, në vetvete, duhet të ketë elementin e përkohshmërisë. Po ashtu, parimi i proporcionalitetit kërkon që sa më i madh të jetë kufizimi aq më i detajuar dhe bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Në këtë këndvështrim, mënyrat alternative të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së tubimit e justifikojnë konceptin e kufizimit të përkohshëm të tyre. Megjithatë, kur këto kufizime zgjasin pa afat, duke humbur karakteristikën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë mënyrat alternative.”⁹⁵

Pra, vetëm lidhur me mungesën e periodicitetit, Gjykata ka arritur në konkluzionin se kemi ndalim tërësor të lirisë së tubimit duke kërkuar nga urdhri i ministrit shfuqizimin e shprehjes “*deri në një urdhër të dytë*”.⁹⁶ Në fakt, ndalimi tërësor i së drejtës, nuk është gjë tjetër veçse shkelje e thelbit të së drejtës së tubimit dhe njërit prej standardeve kushtetuese, të vendosur si filtër nga Kushtetuta për cdo masë që kufizon të drejta.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se kufizimi i lirisë së tubimit në Urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marra në shqyrtim, nuk përmbushin të gjitha standardet e kërkuara ndërkombëtare dhe ato të parashikuara nga Kushtetuta lidhur me kufizimin e lirive dhe të drejtave. Një zgjidhje për shmangien e shkeljes së këtyre standardeve,

⁹⁵ Po aty, para 67.

⁹⁶ Po aty, për më tepër shih dispozitivin.

sidomos në situata të jashtëzakonshme dhe aq më tepër kur kufizimi bëhet nëpërmjet akteve që i përkasin ekzekutivit (në rastin kur përmbushet kriteri i rezervës ligjore relative) e gjejmë në fakt si sugjerim në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese nr.11/2021. Ky sugjerim, i cili do të duhej të kthehet në praktikë ligjore dhe institucionale, kërkon një shkallë më të lartë kontrolli të pushtetit legjislativ, shoqëruar kjo me një nivel më të lartë llogaridhënie dhe transparence nga ana e institucioneve të ekzekutivit. Pavarësisht autorizimeve ligjore të dhëna ekzekutivit në rastin e rezervës ligjore relative, aktet e këtij të fundit duhet të jenë të aryetuara dhe të sqaruara pa lënë vend për interpretime alternative në relacione shpjeguese. Ratio legis e akteve, qartësia e tyre, respektimi i kufijve të delegimit dhe përmbushja e standardeve kushtetuese lidhur me kufizimin e të drejtave duhet të jetë objekt kontrolli nga Kuvendi. Ky i fundit duhet të çertifikojë masat e marra, në rastet kur aplikohen regjime juridike që kërkojnë ndërhyrje të shpejta, të cilat ndikojnë apo çenojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

VI. Përfundime

Pandemia i vendosi shtetet para përgjegjësisë për të reaguar në mënyrë të shpejtë, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve, me masa që nuk çenojnë liritë e të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Të gjendur në befasi, para një virusi me shumë të panjohura që kërkonte reagim të menjëhershëm, jo çdo shtet, apo masë kufizuese e marrë, arriti të kalonte me sukses testin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Artikulli trajtoi një rast të tillë, ku u evidentua që kufizimi i lirisë së tubimit, në shtete me demokraci të brishtë, nuk iu përmbajt standardeve ndërkombëtare e kushtetuese të kufizimit të të drejtave e të lirive. Megjithatë, në situata që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, siç u konfirmua së fundmi dhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, për të shmangur çdo cënim standardi, duhet që autoritetet t'i kushtojnë një rëndësi të theksuar *ratio legis* dhe qartësisë së akteve që ndërhyjnë në të liritë e njeriut, duke kërkuar një përfshirje më të madhe të organeve

ligjvënëse në marrjen e tyre. Organet ekzekutive, duhet të kenë një nivel të madh transparence, të shoqëruar me llogaridhënie e kontroll të organeve legjislative. Një përgjegjshmëri më e madhe dhe filtra shtesë kontrolli, do të mundësojnë që testi i qartësisë, qëllimit të ligjshëm, nevojës, domosdoshmërisë, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të masës kufizuese të jetë në përputhje me standardet vendase dhe ato të elaboruara nga e drejta ndërkombëtare.

Referencat

Akt Normativ 3/2020 ‘Për Marrjen e Masave të Veçanta Administrative gjatë Kohëzgjatjes së Periudhës së Infeksionit të Shkaktuar nga Covid-19’ <<https://www.asp.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/akt-normativ-2020-03-15-3.pdf>> aksesuar më 12 Maj 2021

Asambleja e Përgjithshme, ‘Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut’ <https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf> aksesuar më 1 Maj 2021

Bączkowski and Others v. Poland, No. 1543/06, § 61, 3 May 2007.

Bianku L, et. al., *Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut: Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (Aire Centre 2020)

Bukta and Others v. Hungary, Application No 25691/04, 17 July 2007

Cisse v. France, Application No 51346/99, 9 April 2002

Djavit An v. Turkey, No. 20652/92, § 56, 20 February 2003

Ducharme J, ‘World Health Organization Declares COVID-19 a Pandemic’ (11 Mars 2020) <<https://time.com/5791661/who-coronavirus-pandemic-declaration/>> aksesuar më 10 Prill 2021

DË, ‘Germany’s top court overturns Stuttgart’s protest ban’ (2020) <<https://www.dw.com/en/germanys-top-court-overturns-stuttgarts-protest-ban/a-53175992>> aksesuar më 1 Prill 2021

European Council, ‘Cologne European Council 3-4 June 1999’ (Conclusions of the Presidency) <https://ëëë.europarl.europa.eu/summits/kol1_en.htm> accessed 2 February 2021

Eva Molnár v. Hungary, Application No 10346/05, 7 October 2008

Ezelin v. France, Application No. 11800/85

Fáber v. Hungary, Application No 40721/08, 24 July 2012.

General Assembly Res. 72/135, *Rights to freedom of peaceful assembly and of association*, [2017] U.N. Doc. A/72/135.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Vendimi KO61/20.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 1/2013

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 20/2006

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 33/2016

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 52/2012

Gjykata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 11/2021

Gjykata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 16/2004

Gjykata Kushtetuese Shqiptare, Vendimi Nr. 35/2007.

Gjykata Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane, BVerfGE 76.

House of Commons and House of Lords, ‘The Government response to covid-19: freedom of assembly and the right to protest’ (Thirteenth Report of Session 2019–21)
<<https://committees.parliament.uk/publications/5153/documents/50935/default/>> aksesuar më 15 Maj 2021

Këshilli i Evropës, ‘Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19 -Paketë për shtetet anëtare’ (Dokument Informativ SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020), <https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>> aksesuar më 14 Prill 2021.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966

Kudrevičius and others v. Lithuania, No 37553/05, § 91, 15 October 2015

Lashmankin and Others v. Russia, Applications No 57818/09

Ligj nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” [2016] GZ 46

Ligji 45/2019, “Për mbrojtjen civile” [2019] GZ 113

Ligji 8417/1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’ [1998] GZ 28 ndryshuar me Ligjin 115/2020, Për disa ndryshime në Ligjin Ligji 8417/1998’ [2020] GZ 153 (Kushtetuta)

Lord GOLDSMITH QC, ‘A Charter of Rights, freedoms and principles’ (2001) Vol. 38, *Common Market Laë Review*, p. 1216

Moscow Branch of the Salvation Army v. Russia, No. 72881/01, 5 october 2006.

Nowak M, *U.N. Covenant on Civil and Political Rights: CCPR Commentary* (2nd revised edition, N.P.Engel Publisher 2005)

Petrela I dhe Xhepa I, *Manual: Liria e Tubimit dhe e Organizimit* (Konrad Adebauer Stiftund, Rule of Law 2020)

Plattform “Ärzte für das Leben” v. Austria, Application No 10126/82, 21 June 1988

Refah Partisi (the Welfare Party) and Others v. Turkey [GC], Application Nos. 41340/98, 41342/98, 41343/98 and 41344/98

Schabas A W, *The European Convention on Human Rights* (OUP 2015) 484-490.

Staatkundig Gereformeerde Partij v. the Netherlands, Application No. 58369/10, 10 July 2012

Stankov and the United Macedonian Organisation Ilinden v. Bulgaria, Application No. 29221/95 and 29225/95, 2 October 2001.

Tatár and Fáber v. Hungary, Application No. 26005/08 and 26160/08, 12 June 2012.

Urdhër 132/2020, ‘Për Mbylljen e Aktiviteteve Publike dhe Jopublike dhe Anullimin e Grumbullimeve Masive në Vende të Mbyllura apo të Hapura’ <<https://portavendore.al/ep->

content/uploads/2020/04/Urdh%C3%ABr-nr.132-dt.-08.03.2020.pdf> aksesuar më 12 Maj 2021

Urdhër 156/2/2020 ‘Për Shpalljen e Gjendjes së Epidemisë nga Infeksioni’ < <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Urdher-156.2-Shpalljen-e-Gjendjes-se-Epidemise-nga-Infeksioni-COVID-19.pdf>> aksesuar më 1 Maj 2021

Urdhër 351/2020 ‘Për Marrjen e Masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid -19’ <<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/05/Urdher-Nr.351.pdf>> aksesuar më 12 Maj 2021

Urdhër 633/2020 ‘Për Ndalimin e Grumbullimeve në Vende të Mbyllura apo të Hapura’ <<https://shendetesia.gov.al/epcontent/uploads/2020/11/Urdher-nr.633-2.pdf>> aksesuar më 12 Maj 2021

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) 243/2020 ‘Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore’ <<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx..pdf>> aksesuar më 12 Maj 2021

Venice Commission and OSCE/ODIHR, *Guidelines on Freedom of Peacefull Assembly* (3rd edition, Strasbourg / Warsaw 2019).

Irena SHEHU &
Enkeleda JATA⁹⁷

**CHALLENGES AND OPPORTUNITIES
OF TEACHING ESP ONLINE
(A case study of Agricultural University of Tirana
and Faculty of Natural Sciences at UT)**

Abstract

Covid19 changed the world in all dimensions. As the world went through lock down, all universities cancelled classroom courses and proceeded to online courses. Being unprepared for this situation, educators faced a new reality of teaching full of challenges and had to seek possible opportunities to make the learning process as effective as possible.

Thus, the purpose of this paper is to bring a new insight of ESP online teaching experience in an Albanian Universities, aiming to bring effective solutions.

In order to give a more generalized mirror of this experience and more inclusive data, as a sample of this study, there are used 100 students from two different universities of Albania: Agricultural University of Tirana, Faculty of Natural Sciences at University of Tirana.

Keywords: *ESP, online teaching, challenges, methodology*

⁹⁷ Dr. Irena Shehu
University College Beder
ishehu@beder.edu.al
Dr. Enkeleda Jata
Agricultural University of Tirana
ejata@ubt.edu.al

I. INTRODUCTION

ESP is not a new term in the area of language studies. The term ESP (English for Specific Purposes) has been appeared back to classical times (Hutchinson, 1987). Specifically, from the early 1960's, ESP was developed and became one of the most important areas of language teaching in nowadays.

According to (Dudley-Evans, 1997) ESP is defined based on these Absolute Characteristics:

1. ESP is defined to meet specific needs of the learners
2. ESP makes use of underlying methodology and activities of the discipline it serves
3. ESP is centered on the language appropriate to these activities in terms of grammar, lexis, register, study skills, discourse and genre.

Hutchinson and Waters (1987, p 19) have another view of ESP. They see it as a broad approach rather than a product. According to them ESP does not involve a particular kind of language, teaching material or methodology.

There are even important scientific journals which deal specifically with the research and finding in the field of ESP, such as the international journal dedicated to ESP discussion, "English for Specific Purposes. There is done a huge progress in developing new methods and tools in an attempt to effective ESP teaching.

But what happened in late 2019 and the beginning of 2020? The world was faced with a new reality, Covid-19 Pandemic. Being faced with this situation, most of the traditional models of language education have become grossly inadequate to meet the challenges of teaching online.

Review from previous studies on this topic

First, let us refer to Moorhouse (2020), who conducted a study with the aim of investigating the challenges of teaching ESP during the pandemic. Among the most important findings, he listed some difficulties when running the class online both synchronously and asynchronously such as students' minimum participation during the class, their preference to be passive participants, and teachers' limited knowledge on using the video-conferencing application.

Another important author who conducted a similar study in teaching challenges and opportunities during pandemic period is Yang (2020). He listed a lot of obstacles during distance learning such as students' lack of skills in self-study, the unreliable internet connection and learning platforms, difficulty in monitoring students' learning progress, and the lack of interaction with the students.

Iswati, L. (2020) brought similar important findings on challenges of teaching ESP online

1.1 Context

The context of this study is ESP online teaching in Albanian Universities. In Albania there are around 40 universities, counting both Public and Private Institutions where ESP is a crucial part of each program and area of study.

Like the whole World, Albania was faced with the Covid-19 Pandemic. ESP lecturers faced lots of challenges while teaching online. Thus, the purpose of this paper is to bring a new insight of ESP online teaching experience on two Albanian Universities, aiming to contributing to effective teaching and language learning.

In order to give a more generalized mirror of this experience and more inclusive data, the study focus on two important universities of Albania: The Agricultural University of Tirana and Faculty of Natural Sciences at University of Tirana.

II. Methodology

This study is based on a descriptive methodology based on the observations and experimentation.

Period: Spring and Fall Semester 2020

Sample of the study:

1. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences, ESP in the Bachelor study program of Informatics, number of students 50.
Number of groups:2

2. The Agricultural University of Tirana, ESP in the Bachelor study program of Agriculture and Environment and Applied Economics, number of students 184 students number of groups 8

The data are collected based on notes taken upon the experimentation and observation conducted on the weekly basis.

Teaching Methods used:

At University of Tirana, Faculty of Natural Sciences, initially Google platform, specifically Google classroom and Meet were used. Later, it was preceded with Microsoft Teams.

While concerning the online teaching methodology, the lectures were built upon:

- Open discussions over given topics
- Mixing up lessons
- Keeping students busy

Materials used:

The basic book: English for sciences, Tirane 2019

Extra materials: Exercises online from different web pages such as: <https://www.englisch-hilfen.de/en/> , <https://www.esleschool.com/>

At the Agricultural University of Tirana (AUT), it is used Zoom Meeting for teaching ESP online, Google classroom for sharing the lesson and submitting the assignment, and Google Form for quizzes. Zoom has several useful features that can be used with online lessons, such as scheduling, sharing the screen, creating breakout rooms, etc. In this way, it allows managing and monitoring the learners' activities.

Online Teaching Course Plan

1. Brainstorming (starting the lesson with a question)
2. Group work, group exercises, writing task.
3. Explain grammar; vocabulary; focusing on the new terminology.
4. Listening Tasks; videos to listen and questions to answers
5. Mix up of the activities to keep it interesting
6. Summary of the main issues on what was conducted during the session

Materials used: English in Focus “Agriculture and Environment” & English for Business & Finance, Tirana 2018.

Extra materials: First Certificate Language Practice 4th Edition Macmillan, different web pages and videos to watch online.

III. Analysis of challenges and opportunities recognized at both Universities

At both universities there are faced almost the same challenges and opportunities. Thus in the section above there is given a conclusion of the most important challenges and opportunities faced in both contexts.

Challenges:

Online teaching is based on the traditional teaching method, even though it is more challenging. Teachers had to improve and boost their technology-related skills and use them to be creative during the

pandemic period, to stimulate the interest of their students. In a short time, they found themselves not only providing online lessons and presentations, but also having the exams in an online platform and assessing their performance. Simultaneously, they had to redesign the course and assessment plan. Testing students accurately was among of the most prominent challenges. The assessment of the students was done online through their assignments, projects, and quizzes performed through Google classroom.

Different types of problems have emerged during online lessons such as internet connection problems (students not having internet at home or sometimes connection failure during the online sessions), electricity problems, a vast number of students attending an online lesson, students not equipped with a computer (learning and reading from a small screen of a phone is difficult), lack of direct contact with the students which makes it difficult to observe their reaction (whether they understood or not the lesson), students infected with the virus who could not participate in the online lesson, etc. These series of challenges make it difficult to get feedback and assess the students' performance through a web classroom. At the same time, considering all these problems, we had to choose by combining a-synchronous and synchronous communication with the students in order to facility this process.

Difficulty in overseeing students' learning progress is another challenge which was greatly supported as well by Wong (2020) who reveals that it is difficult for teachers to supervise students during online learning, and Yang (2020) who concludes that monitoring students' progress in learning is not an easy task.

To add to the list, we can say that at both universities it was noted that students were not punctual and they lacked the discipline to attend online on the schedule. This challenge was also an important finding of Iswati, L. (2020).

To conclude, teaching from home is one of the greatest challenges of all teachers who were obliged to hold lectures from home.

Opportunities:

While we listed the challenges it seemed that there were not any benefits from online teaching, but in fact, this is not true.

Online learning platforms have benefits for students who are learning a language, especially ESP. Via online teaching, we are given the opportunity to deliver listening tasks and develop listening skills, which is difficult to be developed in the auditorium of traditional classes. Zoom Meeting offers the opportunity to create working groups like in a real classroom, and these groups of students can discuss a topic assigned to them. While the breaking rooms are taking place, the teacher can enter different rooms to assess the student's progress and evaluate the performance.

Another opportunity is developing writing skills. Since students were merely assessed through assignments, they had to write twice or more than in usual physical classrooms. Thus, they developed more writhing skills.

Lastly, being almost experts in technology for both students and teachers can be regarded as a good opportunity which emerged from online teaching. Compared to the previous normal situations, despite the difficulties, now both students and teachers show great competences on the technology use.

Conclusion

School is a shared experience, not only a place to learn and teach. Replacing the auditorium lessons with online lessons is not as much engaging. It is considerably exhausting to teach and learn online.

One of the problems we encountered in online teaching is the “engagement issue”. Online teaching/learning can decrease students’ motivation, and teachers are using all strategies to capture students’ attention and incite students to be more collaborative during the lesson.

Switching learning to be conducted online is not a mere case of using an appropriate kind of technology, it involves a lot of components, most importantly, and the human aspect should be seriously taken into account.

References

1. Dudley-Evans, Tony (1998). *Developments in English for Specific Purposes: A multi-disciplinary approach*. Cambridge University Press. (Forthcoming)
2. Fernando Ferri, Patrizia Grifoni and Tiziana Guzzo “Online Learning and Emergency Remote Teaching: Opportunities and Challenges in Emergency Situations”
<file:///C:/Users/oem/AppData/Local/Temp/societies-10-00086.pdf>
3. Gwen Le Cor and Margaux Coutheru Online courses in times of pandemic: ESP and applied English classes at Université Paris 8 Aspla revue du GERAS78 | 2020 Cours LANSAD à distance en situation de crise sanitaire <file:///C:/Users/oem/AppData/Local/Temp/asp-6481.pdf>
4. Hutchinson, Tom & Waters, Alan (1987). *English for Specific Purposes: A learner-centered approach*. Cambridge University Press.
5. Iswati, L. (2020). When Teaching Must Go On: ESP Teachers’ Strategies and Challenges during COVID-19 Pandemic. *Eralingua: Jurnal Pendidikan Bahasa Asing dan Sastra* Vol. 5, No. 1, March 2021
6. Jing Luo, Mark Garner “*The Challenges and Opportunities for English Teachers in Teaching ESP in China*,” published in *Journal of Language Teaching and Research*, Vol. 8, No. 1, pp. 81-86, January 2017 DOI: <http://dx.doi.org/10.17507/jltr.0801.10>, ISSN 1798-4769
7. Moorhouse, B. L. (2020). Adaptations to a face-to-face initial teacher education course ‘forced’ online due to the COVID-19 pandemic. *Journal of Education form Teaching*, 00(00), 1–3. <https://doi.org/10.1080/02607476.2020.1755205>
8. Yang, X. (2020). Teachers’ perceptions of large-scale online teaching as an epidemic prevention and control strategy in China. *ECNU Review of Education*, 1–6. <https://doi.org/10.1177/2096531120922244>

Rahim OMBASHI⁹⁸

QASJE KULTURORE NË NGJIZJEN E NDËRGJEGJES KOMBËTARE

Abstract

It is scientifically argued how the partial return (Albanianization) of the *Qur'an* helped strengthen national consciousness. In order not to talk about vinegar and to skip to milk, we will try to specify how much I. M. Qafëzezi could overcome the usual impossible. The maxim of the Bosnian academic Enes Karic helps in the right direction and clarifies the news brought by weakening the misunderstandings spread through language: (Ambasciano, 2016: 141). Thus the research supports the grateful help to honor the man of letters, who dared to bring in Albanian from English some suras of the *Qur'an*. The missionary national, the founding member of the Xaverjan Albanological Academy, who acknowledges in the preface to the 1921 edition that the impossible test had yielded results, gives the motivating cause neither purely religious nor only philological: "At least, it is time to know what is that mysterious 'onion skin' that separates the Muslim Albanians religiously from their Christian brothers, I am translating the *Qur'an* into Albanian, from the English language." (*KUR'ANI KËNDIMI*, 1921:3) Clarifying that part of the national identity along with the Albanian language is also the Albanian culture, he tried to bring in our language the Holy Book, which helped to strengthen the Muslim religious identity, as part of the national one. In conclusion, the realism of this scientific enterprise coincides with the time, which he felt was a continuation of the days according to the besa of Prizren: "In order to learn from it in their own language, non-Muslims, for the most part, enter the translation of the *Qur'an* for tendentious purposes and especially for missionary purposes." (Shkodra, 2005)

Keywords: *Qur'an*, commentary, return (Albanian), culture, missionary

⁹⁸ Prof. Asoc. Dr. Rahim OMBASHI

rombashi@beder.edu.al

Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Kolegji Universitar "Bedër",

Tiranë

Albania

“Të lexosh një autor të së shkuarës, sipas T. S. Eliot, do të thotë të bësh një tërtherje (neologjizëm i krijuar nga Naum Veqilharxhi në vend të fjalës *sakrificë*), të heqësh dorë momentalisht nga e tashmja jote dhe personaliteti yt në këmbim të diçkaje më të çmuar. Të krijosh intimitet me të vdekurit.”

Duket studenti i Harvardit dhe Nobelisti i letërsisë e pranonte se njeriu, si mbyll detyrimet në këtë botë të përkohshme, mban lidhje me të nëpërmjet veprës që ka lënë, asaj ‘diçkaje më të çmuar’, e cila na ka mbledhur në këtë tubim të fisshëm. Nuk paska qenë ajo vetëm vlerë gjuhësore, albanologjike, artistike dhe kulturore, prandaj një shekull më pas edhe në se nuk e përkujtojnë në qytetin e vet (nuk kam dijeni se në Korçë u krye, po zhvillohet apo do të zhvillohet një veprimtari përkujtimore shkencore në këtë lëmë të dijes), ia vlerëson veprën Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame i BIK, Prishtina, Kosova, ajo pjesë e kombit që tashmë ka dhe shtetin e vet.

Një shekull dhe më herët për qytetin e mësonjëtores së parë shqipe gazeta turke *Aksham* shkruan:

“Si kush e din që Korça është çerdhja e llatinxhinjve. Atje ndodhet një çetë e fortë që prej një kohe të gjatë po merret më propaganda, mundohen për të ringjallur vetëqeverimin kombëtar. Tashti për me i derdh një sqfur në rrënjët e tyre, shkolla shqipe po mbyllet edhe kryetarët e tyre u internuan. Hafiz Aliu u internua në Spartën e Konjës, Orhan beu në Marash, Emin Milka në Urfa, Hysejn Qani Ballanca në Tokat, Sulejman Ohrija në Nigde dhe Thoma Mihal Markoja në Manastir.”

(Ombashi, 2020: 219)

Në këtë qytet u rrit dhe zhvilloi veprimtarinë e tij Hafiz Ali Korça, autori i poemës së ndjerë për Kosovën *Vajtimet e Atdheut*, për të cilën studiuesi Mahmud Hysa shkon aq lart, kur e vlerëson se “... mund të krahasohet lirisht me atë të Mitrush Kutelit.”

Kumtesa, që po mbahet në këtë tubim shkencor përkujtimor, rreket të saktësojë ndonjë të dhënë jo të saktë dhe të argumentojë sesi kthimi (shqipërimi) i pjesshëm i *Kuranit* nga Ilo Mitkë Qafëzezi, i cili u rrit në atë mjedis ku fryma perëndimore ndihej fuqishëm, ndihmoi në forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

Mbështetur te thënia e Volterit se për të gjykuar mbi përgjigjet, duhet të vlerësosh së pari pyetjet, shkrimi e mbështet pyetjen kërkimore tek pohimi i islamologut me frymë e gjuhë bashkëkohore Ramadan Shkodra:

“Punën e parë serioze në këtë drejtim e ndërmori Ilo Mitko Qafëzezi, i cili në Ploeshti të Rumanisë, më 1921, kishte botuar të përkthyer në shqip 6 suret e para të *Kuranit*.”

Te libri “*KURA’NI* përkthyer shqip prej I.M.Q., shtypur ndë Rumani”, pas kushtimit “*Bashkatdhetarëvet Kombëtarë të Shtetevet të Bashkuara t’Amerikës* u dedikohet.”, është vendosur një grishje për t’u futur “ndë rradhë qytetërimi.” drejtuar SHQIPËTARËVET: me plot të dhëna të llojllojshme. Madje guxon dhe të paralajmërojë: “Tjetrazi, jemi të humbur...” Në fund të asaj fjale zemre, pas akronimit I.M.Q., një radhë më poshtë, autori shënon: “RUMANI-Paulești-Prähova, më 10 Mars 1921”, që siguron se ky mjedis i vogël administrativ, Păulești, është një komunë në Qarkun Prahova, Muntenia, Rumani dhe njëkohësisht vendi i shtypjes së librit.

Që të mos flitet për uthullën e të kapërcehet tek qumështi, do të rrekemi të saktësojmë sesa Qafëzezi, që ‘mihte thellë në histori’, sipas akademikut Zef Valentini, mundi të tejkalonte ylberin e kohës plot ngjyra të feksura fetare. E mbështet fort qartësimin se çfarë u mboll dhe mbiu në këtë arë më se profesionale maksima e akademikut boshnjak Enes Kariç, i cili te libri *Si të komentohet Kur’ani* qartëson:

“*Kur’ani* nuk mund të përkthehet, por *Kur’ani* duhet të përkthehet (komentohet)!”

Të rejat e sjella në këtë veprimtari shkencore nën kujdesin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në Prishtinë, do të japin kontribut duke dobësuar keqkuptimet e përhapura përmes stilit funksional fetar, ku një qasje vazhdimisht evolucionare dhe njohëse për studimin e fesë është, në vend të kësaj të përdorur deri tani gjerësisht, mjeti shkencor më premtues dhe themelor për të kapërcyer hendekun midis shkencave humane dhe shkencave natyrore, edhe pse vijon të mbetet një qëllim afatgjatë.

Shpjegimin dhe njëherazi argumentin për ta bërë këtë hap e ofron studiuesi Ambasciano që thekson se “gjuha e vjetëruar e ‘*kulturave aborigjene*’ si muze në ajër të hapur për të kaluarën tonë është e rrënjosur në keqkuptimet e lartpërmendura dhe, megjithëse në thelb me të meta, është ende shumë e gjallë.” Kësisoj hulumtimi, i cili mbështet dhe vlerëson ndihmesën mirënjohëse për të nderuar njeriun e letrave I. M. Qafëzezi, i cili guxoi të sjellë në shqipe nga anglishtja disa sure të *Kuranit*, synon ta vendosë në vendin e duhur, që i shërbeu jo vetëm kohës historike dhe akademike, por edhe epokës etnike.

Ilo Mitkë Qafëzezi, kombëtari misionar, anëtari themelues i Akademisë Albanologjike Xaverjane, themeluar në vitin 1937, ku u botuan për një kohë të shkurtër rreth 400 libra, që e pranon te parathënia e botimit të vet të vitit 1921 sesa rezultat kishte dhënë sprova e kapërcimit të ylberit albanologjik, jep vetë aty shkakun nxitës as vetëm fetar dhe as vetëm filologjik:

“I shtyjtur prej dëshirës që, tani pak-së-paku, është koha të dihet se cila është ajo ‘*cipë qepe*’ misterioze që i ndan fetarisht Shqipëtarët Muhamedanë nga vëllëzërit e tyre të Krështerë, po jap të përkthyer Shqip *Kurânin*, nga gjuha Inglize – përkthim nga *Arabishtja* prej z. George Sales, transllator i shprovuar i *Këndimit Hyjnor*.” (KURA`NI KËNDIMI, 1921: 3)

Si firmëtar i akademizmit albanologjik duke qenë i qartë se pjesë e identitetit kombëtar bashkë me gjuhën shqipe ishte edhe kultura shqiptare, u rrek të sjellë në gjuhën tonë *Librin e shenjtë*, i cili ndihmonte për forcimin e identitetit fetar mysliman, si pjesë e atij etnik, siç ka sqaruar islamologu durimtar dhe kërkuesi shkencor i letërsisë shqipe dhe me plot gjetje autentike Qazim Qazimi. Në një monografi shteruese për Muhamet Çamin, poetin alhamiado, i cili e ka vijuar veprimtarinë e vet poetike duke shkruar në gjuhën shqipe dhe me alfabet arab, ka sqaruar se shqiptarët e përdorën atë lloj alfabeti duke e përshtatur për shqipen, siç kanë bërë edhe persët, osmanët etj. Duket qartë se fryma e krijuar aso kohe kishte lindur më herët, prandaj nuk do të shuhej, ngase realizmi i asaj ndërmarrjeje shkencore me mison kombëtar përkoi dhe përkon me kohën etnike, që akademiku ndiente se ishte vazhdë e sendërtim i ‘ditëvet besëprizrënase’:

“Përderisa myslimanët përkthimit të *Kuranit* i hyjnë si të një libri fetar të zbritur nga Allahu (xh.sh.) me qëllim që të mësojnë nga ai në gjuhën e tyre, jomyslimanët përkthimit të *Kuranit*, të shumtën, i hyjnë për qëllime tendencioze dhe sidomos për qëllime misionariste.” (Shkodra, 2005)

Bashkohem me jo pak shkrime serioze që vlerësojnë gjetjet e nismëtarëve, të cilët iu vunë punës për sjelljen e *Kuranit Fisnik* në gjuhën tonë të lashtë, si nevojë e domosdoshmëri, por më duhet të qëndroj te një detaj, që vlen të ndreqet:

“Përkthimit të *Kuranit* në gjuhën shqipe, pas vendosjes së sistemit komunist në Shqipëri, iu vu edhe dijetari shkodran, imam Vehbi Ismaili, në Nju-Xhersi të ShBA-së (R.O: Detroit, Michigan, USA), por, fatkeqësisht, edhe ky dorëshkrim nuk arriti të botohej dhe i qe grabitur nga një keqbërës rrugës për në shtypshkronjë. (Tërnavë, Naim. 1991: 29)

Mësohet se ka një dorëshkrim që duhet kërkuar në ASHSH dhe një qartësim për informacionin me vlerë të zotëri Tërnavës 20 vjet më parë, që imam Vehbiun e këtillon siç ishte në të vërtetë: dijetar.

Për disa vjet bashkëpunova në AIC Detroit, Michigan, USA me prijësin e shquar dhe jo një herë ma ka përsëritur dhembjen e humbjes së dorëshkrimit të punës së vet më të vlefshme të jetës, por jo në Nju-Xhersi, sepse ai jetoi dhe punoi në Detroit. Më dha disa materiale autentike, që i botova te libri *Po vjen Noli...*, të cilin ia kam kushtuar atij burri e prijësi kombëtar dhe fetar, por që u bë një me termin Imam.

Sipas kronologjisë së sprovave për të sjellë *Kuranin* në shqipe, në krye të saj është një nga frashëllinjte e mëdhenj, bektashiu Naim dhe pas tij

ecën në udhën e çelur kristiani ortodoks Ilo Mitkë Qafzezi, njëri nip me shenjë e tjetri bir i vyer i qytetit të Korçës. Vijuan këtë udhë personalitete, madje së fundi gjejmë një të dhënë që duhet hulumtuar për t’u pranuar si dokument:

“Këto të dhëna që u përmendën si dhe faktin se Ali Asllani ka bërë përkthimin e *Kur’anit* në gjuhën shqipe m’i ka konfirmuar qysh më 1991, Bardhyl Fico, i biri i Rauf Ficos.” (Hysi, 2007)

Shtoj dhe një tjetër autor, pa thënë se përfundova listën jo të shkurtër të atyre që iu futën kësaj sprove jo vetëm gjuhësore apo artistike:

“Po ashtu, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, nën mbikëqyrjen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, shënojmë dhe një nismë për përkthimin e *Kuranit* në gjuhën shqipe. Më 1944 ishte bërë edhe një përkthim, dorëshkrimi i të cilit, sipas z. Ali Musa Bashës, ka përfunduar në Arkivin e Shtetit Shqiptar. (Basha, Ali Musa, 1996: 23-24)

Për të gjitha ato punime ka pasur jo pak vëmendje nga studiues, hulumtues dhe publicistë të fushës, veçse si në shkrime të mirëfillta shkencore apo në shkrime shkencore-popullore, fjala kyç është ‘përkthej’, tek e cila do të qëndroj për ta shkoqitur kuptimisht. Termi ‘përkthej’ më thotë shumë më tepër se fjala ‘përkthej’, që ka këtë kuptim leksikor:

PËRKTHEJ kal.

1. Kthej me shkrim a me gojë diçka nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, duke e ruajtur tërësisht kuptimin e fjalëve e të frazave, e shpreh me fjalët e një gjuhë tjetër atë që është shkruar ose që është thënë, duke i ruajtur plotësisht përmbajtjen. Përkthej një roman (një vjershtë). Përkthej nga anglishtja (nga frëngjishtja, nga rusishtja). Përkthej nga shqipja në italisht. Përkthen lirisht. E

përktheu fjalë për fjalë. Përkthej me gojë (me shkrim). (*Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, 1980, Tiranë) ose fjalori.shkenca.org

Fan Noli guxoi në vitin 1927 të shkruante vetëm ‘shqipëroj’, për sjelljen në shqipe të *Rubairave* të Khajamit, term që është larg shumë nga ‘përkthej’. Në anë tjetër, Qafëzezi i cili ka ndjerë jo vetëm narrativën e kumtit kuranor, por edhe frymën e tij poetike, shkon më lart:

« Në vijim autori e informon lexuesin se veç përkthimit në gjuhën angleze të George Sales, që e ka pasur si bazë për përkthimin e *Kuranit* në gjuhën shqipe, ka konsultuar edhe përkthimin e *Kuranit* në gjuhën frënge të M. Savary, për të cilin shprehet “Prej këtij adoptova më fort numurëlimin *e versetave*, mbasi z. Sales nuk e ka përdorur, gjë` që i-a humbet, sa-do-mos, Librit të Shenjtë frymën poetike. »

(Ombashi, 2020: 118)

Gjithsesi, përkthimi artistik nuk ka qenë qëllim i Qafëzezit, i cili duke ndarë veprimtarinë atdhetare nga përkthimi si zotësi shkencore dhe hartuese del me këtë konstatim:

“Të jetë një ndihmë, sado e pakët për atë teollog që dotë ketë fatbardhësinë të përkthenjë *Kuranin* nga Arabishtja. (*KURA`NI KËNDIMI*, 1921: 3)

Sipas teorive të përkthimit letrar dhe veçmas atij poetik, profesioni i parë i qenies humane është zemra e *hermeneutikës* (Hermesi mitik shkoqiste kuptimin e teksteve). Fridrih Shlejemaker (Fridrich Schleiermacher, 1769-1834) e themeloi *hermeneutikën* si një teori të përgjithshme të interpretimit, si një art universal të kuptimit, të zbatuar në të gjitha sferat e dijes humanitare, para së gjithash, në filozofi. Sipas fjalëve të tij:

“Hermeneutika është shkenca që i largohet keqkuptimit, e cila duhet të themelohet në bazë të një kodi gramatik dhe psikologjik të interpretimit.”

Si parim të rëndësishëm, ai futi argumentimin e domosdoshmërisë për të kuptuar jo vetëm tekstin, por edhe individualitetin e hartuesit të tij. Për këtë duhej riprodhuar, si të thuash, akti kompozues i autorit të veprës. Kjo e shtyu Shlejemakerin të formulojë tezën e tij aq popullore për shkencëtarët e letërsisë, sipas së cilës ‘përkthyesi apo interpreti duhet ta njohë shkrimtarin më mirë sesa e njeh ai veten e tij’.

Përgjatë rindërtimit të aktit ngjizës, përkthyesi-shkencëtar ka mundësi të mbërrijë apo përkapë diç, që deri në fund nuk ka qenë e qartë për vetë hartuesin e veprës. Sipas tij, individualitetin e autorit duhet ta mbërrish drejtpërsëdrejti, duke e shndërruar veten në tjetrin-autor. Metoda e kuptimit të këtij teoricieni është sa krahasuese (për të është i domosdoshëm krahasimi me të tërën), aq edhe hyjnizuese (hamendësimi, intuita, përndritja gjatë riprodhimit të aktit të veprës së huaj). Kjo nënkupton një cikël të njëpasnjëshëm të interpretimit gjatë ndërkalimit nga e përveçmja tek e përgjithshmja dhe anasjellas, derisa të jetë përkapur kuptimi, sepse ‘asgjë e interpretuar nuk mund të kuptohet vetëm me një herë’.

Si titullar i lëndës *Teoritë e përkthimit*, për të bërë krahasimin midis tekstit origjinal dhe atij të përkthyer, zgjedh poezinë e J. V. Gëtes *Mbreti i Tulës* përkthyer nga Ndre Mjeda më herët e më pas nga Sejfulla Maleshova, Vehbi Bala, Jorgo Bllaci e të tjerë. Në këtë kurs të plotë teoriko-praktik, që merret në ciklin e dytë të studimeve “Master i

shkencave” të programit të studimit *Shkenca komunikimi*, profili *Gazetari*, mjaft studentë kanë argumentuar dhe pranuar se përkthimi i Mjedës është më i bukur se origjinali. Fill për këtë arsye themelore, fjalën ‘përkthej’, siç e keni vënë re më lart, nuk e përdor si term të studimeve të letërsisë artistike, por me kuptimin leksikor të përgjithshëm relativizues.

Kjo peshë e rëndë e shtyu Kryetarin e Parlamentit të parë Shqiptar dhe më pas Kryetarin e parë të KMSH të paralajmërojë:

Deklaratë e Krye Myftiut

“Nji punë aqë e randë asht kjo qi edhe të dijshtmit me famë e të njoftun edhe n’Europë si Fahredin Raziu me shokë kanë mbet të dridhueshëm në përmbushjen e sajë.”

Vehbi (d.v.)

Kolana “Zani i Naltë”, 1: 1923-1924-1925, fq. 384.

Nr. 12, shtator 1924.

Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur’anit në gjuhën shqipe, titullohet shkrimi grishës i Elez Ismailit, botuar te *Zëri Islam* në vitin 2016, që dëshmon se ende ka nevojë për ndihmesa në këtë lëmë të dijes. (Ismaili, 2016)

Studimi i rolit të fesë gjatë Rilindjes sonë Kombëtare, padyshim, bën pjesë në mesin e temave, të cilat në historiografinë dhe albanologjinë shqiptare nuk janë bërë sa dhe si duhet objekt i studimit, madje dhe më tej, për ngjarje dhe figura historike ka pasur heshtim institucional. Dihet shumë mirë se besimet fetare, në momentet më kyçe të vendosjes së fatit të kombeve të ndryshëm, kanë luajtur rol të rëndësishëm, e që vazhdojnë ta luajnë edhe sot. Nga ky rregull nuk

përrjashtohen as shqiptarët, të cilët, në çastet kulmore të historisë së tyre, u ngritën, u organizuan dhe punuan e luftuan me besë, penë e armë kundër pushtuesve të huaj, duke e vënë në veprim me këtë rast edhe elementin fetar.

Studiuesi Memli Krasniqi në një punim që mbulon periudhën kohore nga viti 1814-1897, argumenton se koha solli në arenën botërore një organizim të ri social, ekonomik dhe politik, i cili, në masën më të madhe, u mbështet në vlerat shpirtërore dhe morale të Kishave Protestante që si themel kishin edhe vlerat e lashta greke e romake:

“Dëshira për të studiuar dhe për të shkruar mbi ndikimin dominues fesë (të religjionit) në krijimin ose modelimin e mentaliteteteve, jo vetëm të atyre individuale dhe sociale, por edhe të atyre etnike, më ka lindur disa vite para se vërtetë t’ia filloja punës për realizimin e këtij studimi. Nxitësi, padyshim vendimtar, për t’u marrë me këtë temë ishte libri *Sëmundja teknokrate* i autorit Alain Peyrefitte. Gjatë leximit të këtij libri mbeta i habitur me guximin e autorit. Duke e krahasuar të kaluarën e popullit francez dhe të atij gjerman, ky autor gjen argumente dhe nxjerr përfundime të logjikshme, për të dëshmuar arsyet e suksesit gjerman në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore dhe njëkohësisht qartësisht zbulon të metat dhe dobësitë e shoqërisë franceze.” (Krasniqi, 2013)

Asaj që e pranojnë shkencat ekonomike se për zhvillimin ekonomik të një vendi duhet kapital dhe faktori njeri, Peyrefitte i shton edhe kulturën si faktor përcaktues në krijimin e mendësisë dhe shprehive prodhuese.

Studiuesi i guximshëm francez shpjegon arsyet se pse revolucioni industrial dhe fryma e re kapitaliste së pari lulëzuan në vendet evropiane protestante. Një nga arsyet e këtij sukseesi protestant, ngulmon ai, është përkthimi i *Biblës* nga latinishtja zyrtare në gjermanishten e folur

nga Martin Luteri e pastaj në gjuhët popullore të vendeve të Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Promovimi i gjuhëve të folura theu monopolin gjuhësor latin të Kishës Katolike si edhe unitetin shpirtëror të Perëndimit katolik.

Thyerja e këtij dogmatizmi dhe centralizimi zgjeroi hapësirat e lirisë së kishave protestante, forcoi frymën lokale dhe etnike në kishat e këtyre vendeve, theksoi tiparet ndryshe të mendësive vendore dhe u cceli udhë marrjes së më shumë përgjegjësi vetjake dhe kolektive. Në vijim, sipas teorisë, lind dhe zhvillohet një mënyre të re e të menduarit dhe e të vepruarit, që rriti kujdesin për edukimin e banorëve të borgeve (varosheve, periferive) urbane dhe pastaj të zonave rurale, gjithnjë në frymë fetare.

Vargu i Pashko Vasës “Feja e shqyptarit asht shqyptaria” është interpretuar tinëzisht e ideologjikisht, sepse faktet flasin që ndikimi i fesë në epokën e rizgjimit tonë kombëtar ka qenë konkret. *Shoqëria Biblike Britanike* ka dhënë një kontribut të vyer jo vetëm për komunitetin e krishterë, por edhe për bashkëkombasit e besimeve të tjera.

“Nga takimet që pati me Naim Frashërin, Gjerasim Qiriazin erdhi në përfundim se për ta siguruar ekzistencën e popullit shqiptar, duhet të botohen tekste shkollore në gjuhën amtare. Kështu, në vitin 1889, ai përgatiti dhe përshtati si tekste shkollore pesë librat e parë të *Biblës*. Alfabeti me të cilin u botuan këto vepra ishte ai i Stambollit, i cili ishte rezultat i marrëveshjes së Shoqërisë Biblike me Naim Frashërin. (Krasniqi, 2013: 387)

Ndonëse protestantizmi, si doktrinë fetare, nuk pati shtrirje dhe ndikim të gjerë në mjedisin ballkanik, pra as në atë shqiptar, misionet

protestante mundën t'i mbështesin dy synimet e paracaktuara: arsimimin dhe edukimin masiv:

“Për ndryshim prej tyre, *Bektashizmi* pati lulëzim të plotë në mjedisin shqiptar, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX, sepse arriti të identifikohet plotësisht me idetë kombëtare shqiptare, si dhe me pranimin e menjëhershëm të alfabetit me shenja latine, që ishte një veprim simbolik, i cili tregonte orientimin drejt vlerave evropiane. (Krasniqi, 2013: 390).

Me të drejtë është dalë te përfundimi:

Prandaj, laiciteti - së pari të qenit shqiptar, i shoqëruar me bashkëjetesë fetare, u bë tipari kryesor i nacionalizmit shqiptar. (Demjaha & Peci, 2016: 79)

Manastiri, kryeqendra e vilajetit dhe qyteti multikulturor i familjes Qiriazhi kishte marrëdhënie të shumta me nahijen e Korçës, prandaj ata e zgjodhën atë qytet për çeljen e shkollës së parë të vashave më 1891, ku do të shkolloheshin pa dallim fetar. Edhe Qafëzezi ka drejtuar shkollën e vllahëve në qytet dhe me siguri që ka parë ndikimin e saj në jetën e qytetit dhe krahinës, por ndikimi i protestanizmit mbi atë do të ketë filluar qysh gjatë periudhës së tij të mërgimit në Rumani dhe do të jetë përforcuar prej mërgatës shqiptare në SHBA, ku aso kohe kishin mërguar motrat Qiriazhi, me të cilat ka bashkëpunuar gjatë. I bindur se kultura është pjesë e identitetit kombëtar, ai thekson:

“Historia edhe gjuha janë lidhjet më të shëndosha që i bashkojnë njerëzit e njëj kombi. Përandaja ndër përhapësit e idhesë, kombëtare shqipëtare dhe të bashkimit kombëtar ndë ditët para e pas Besës së Prizrenit gjejmë, përveç Veqilharxhit - prekursorit

të parë të të zgjuarit të ndërgjegjes kombëtare - një Girolamo de Radë, Hoxhë Tahsin, Kupitor, Mitro Kamardë, Mitko, Vreto, Thimjo Kreji, Sami Frashëri e të tjerë, që janë hedh urë me shpirt e me zemër në studime historike e ligvistike, të cilat, për pasonjë, patnë çvillimin shkallësisht të kulturës shqipe në llaust dhe, më pas, pamvarësinë t'ënë kombëtare.

Këjo apostullatë shqipëtare e botonjësit të "Valëvet të Detit" që ka qënë Spiro Dineja Vithkuqari, do të duket ndë dritë shumë më të çkëlqyerë edhe prej serisë së dorëshkrimevet të “Kolekcionit Dine” që kemi premtuar dhe kemi nisur t'i nxierim në disa kopje, në origjinale me grafinë shqipe të sotme, dhe të cilat përfaqësojnë një pjesë të plejadës së intelektualëve më të zgjedhurë të ditëvev besëprizrënase.” (Gazeta *Tomori*, Tiranë 21 - 22 janar 1943). Përgatitur nga Maksim Gjinaj

Duke ecur me përkushtimin dhe seriozitetin e duhur në këtë dhiare, që do t'u çelte udhë studimeve akademike, Qafëzezi u vlerësua duke u pranuar tek Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare, shkurt Instituti i Studimeve Shqiptare (1940-1944), një qendër shkencore e kulturore e çelur përgjatë Mbretërisë Shqiptare dhe që duke ecur në hullinë e çelur disa vite më parë, i parapriu Institutit të Shkencave, që shërbeu si themel për ngjizjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në të parin institucion akademik kombëtar, Qafëzezi u zgjodh midis 48 anëtarëve të përjetshëm që formonin edhe Këshillin e Përgjithshëm. Kryetar i tij u zgjodh Ernest Koliqi, kurse sekretar i përgjithshëm At Zef Valentini. Duke parë që anëtarë të këtij institucioni ishin ikona të inteligjencies shqiptare, si: Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, At Anton Harapi, Karl Gurakuqi, Lasgush Poradeci, Namik Resuli, Dom Lazër

Shantoja, Filip Fishta, At Justin Rrota, Anton Paluca, Xhevat Korça, Kolë Kamsi, Ekrem Vlora, Sotir Kolea, Vangjel Koça, Dhimitër Berati etj, pranon që autodidakti me gjetjet e veta kërkimore kishte bërë vend midis prijësve të elitës shqiptare të dijes. (AQSH, F. 200, V. 1940, D. 1.)

Studimet albanologjike aso kohe e ngritën qendrën në Tiranë, pas kohësh që kryeshin nga të huajt dhe jashtë atdheut, prandaj atë e vlerësonin personalisht, siç nuk ndodh zakonisht, edhe në Korçën e arsimit dhe të sqimës kombëtare, në qytetin e vet, siç dëshmon bejtja miqësore e satiristit Kapa (Kristaq Cepa) te rubrika humoristike *Kartolinë urimi për vitin e ri 1940*:

“Xhaxhi Ilos Qafëzes / I kam sjellë plot një thes / Dokumenta 40 okë / Dhaskal Todhër, Dhaskal Gjokë.”

Me mençuri, përkushtim intelektual e kombëtar, që të mos ftohej fryma që ngroh shpirti i lirisë, më tepër se me shkollim në auditore universitare në gjuhë e vende të huaja, ai u vendos në listën e shkurtër të personaliteteve të kombit, që mbi Kushtetuta e Gjykata ka vënë Besën e dëlirë. Shqiptari mysliman vihet në ‘be’, theksohet te *Kanuni i Maleve*, mbasi ka marrë avdes...

Kur betohej për të mbrojtur lirinë e vet, nuk harronte të mos e kalonte të drejtën e tjetrit, duke e futur brenda në zemër. Dhe ngjiste aq shumë me normat etike të popujve më të qytetëruar. Në fjalimin mbi “Shpirtin e lirisë”

mbajtur në Central Park të qytetit të New Yorkut, gjyqtari i shquar amerikan Learned Hand theksoi:

“Liria qëndron në zemrat e burrave dhe grave. Kur ajo vdes atje, asnjë Kushtetutë, asnjë ligj, asnjë Gjykatë nuk mund ta shpëtojë atë; asnjë Kushtetutë, asnjë ligj, asnjë Gjykatë nuk mund ta ndihmojë atë. Nëse liria qëndron në zemrat e njerëzve, nuk ka nevojë për Kushtetutë, ligj, Gjykatë për ta shpëtuar.”

Për besimtarin mysliman liria nuk është vullnet i pamëshirshëm, i shfrenuar; nuk është liri të bësh si të duash, sepse ky është mohimi i lirisë dhe çon drejt përmbysjes së saj. Një shoqëri, në të cilën disa njerëz nuk njohin asnjë kontroll mbi lirinë e tyre, së shpejti bëhet një shoqëri ku liria është pronë vetëm e më të fortit, siç edhe e provoi fatkeqësisht.

Pas Luftës së Dytë Botërore, qysh nga viti 1945, ai vijoi të nderohej rastësisht nga institucionet rishtare, duke u ftuar në tubime kulturore “teku isha edhe si mysafir zyrtar i kongresit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë”, siç pohon vetë te një letër që ia drejton një shtetari të lartë të kohës. Nuk vijoi gjatë, sepse pas ndezjes së motorit të luftës së klasave si forcë lëvizëse e shoqërisë moniste, mbështetur me entuziazëm nga zyrtarët e rinj të emëruar politikisht, nënçmimit të etikës dhe fabrikimit të moralit intelektual, Qafëzezit iu desh të përballej me tjetërsimin e veprës hulumtuese dhe studiuese, madje arrihej deri te moscekja e pronësinë intelektuale apo deri në përvetësimin e saj.

Studiuesi kishte depozituar gjatë Luftës në Institutin e Studimeve Shqiptare disa vepra të veta, që kaluan pas nëntorit 1944 në pronësi të Institutit të Shkencave, ku drejtonte Manol Konomi, i cili njëherazi ishte dhe Ministër i Drejtësisë.

Te studimi *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri* (1944-1990), i autorit Leka Ndoja, mësohet se Shuteriqi i ri, i cili nuk i njihte dy gjuhët e vdekura të kulturës botërore: greqisht dhe latinisht, është mbështetur nga mallsjabiu Qafëzezi, ndihmesë e pakursyer që nuk iu shpërblye as me mirënjohje, të paktën, për studimet me karakter epigrafik të shkrimtarëve të vjetër shqiptarë, sidomos të shkollës së Voskopojës, duke mos i paraqitur me akribinë shkencore dhe pa iu cituar pronësinë intelektuale. (Ndoja, 2013: 96)

Sistemi i ri politiko-ekonomik, qysh në ditët e para të tij, do të fillonte shtetëzimin e pronave të pasunarëve të mëdhenj, për të vijuar me ato të pronarëve të mesëm dhe më pas edhe të vegjël. Synimi strategjik i sistemit totalitar ishte shkatërrimi përfundimtar i pronës personale, përfshi edhe asaj intelektuale, çka dëmtoi rëndë dinjitetin qytetar e deri ndërgjegjen e brishtë kombëtare.

Në tetor të vitit 1945, Qafëzezi i moshuar dhe i sëmurë ngre shqetësimin e tij për mbijetesë sepse po "... vuan urie pas 50 vjet pune të paprajtun në fushë të Shqypes." Duket nga mendësia universale apo puna e shumë ngulmuese në kërkim të thesarit kulturor kombëtar, nuk ka mundur të kontaktojë me shkrime që përhapnin e propagandonin teorinë marksiste-leniniste, prandaj mendon se ende zotëron dinjitetin e dikurshëm, që bashkë me vlerat e tjera kërkon të mbështetet edhe nga e drejta e

lëvizjes, e cila do të humbte fare pas prishjes politike me Jugosllavinë federative.

Në letrën dërguar Nako Spirut, drejtues i lartë i aparatit shtetëror njëpartiak dhe njëkohësisht kryetar i Organizatës së Rinisë Antifashiste të Shqipërisë, shkruhet:

Dokumenti 20

(1935-1955): Allbanollogji, Histori, Folklor ett.

Rruga Papa Llambro Ballamaçi 4
Nr. Protokolli 291/ 1
VDEKJE FASHIZMIT - LIRI POPULLIT
Korçë, 22 Shëmitër 1945

Shokut NAKO SPIRU
Kryesonjës i "BRASH" -it.
Tiranë

“Shkurtimi,
Mbi çështjen e 13 Dorëshkrimevet të mij, Studime Epirotike Akademike Anti-Kotokiste ⁹⁹, që i more prej Redakcisë së "Bashkimit" dhe ua këmbeve destinatën, pa përfillur mallajibiun (te zon' e djersës) që i punoj plot dy muaj. Ke këputur kesi mënyre, edhe kafshatën buke të fëmijës së një plaku shkrimtar i cili, për arsye pleqërie dhe sëmundje, vuan urie pas 50 vjet pune të paprajtun në fushë të Shqypes.”

Duke iu drejtuar me dinjitet ‘Shokut Nako’, sepse ka besim te ‘Drejtësia e Drejtë’, kërkon një kthjellim të meselesë së vet letrare dhe tregon se i ka lënë kartvizitën, sepse ai nuk e kishte pranuar në pritje:

“I sëmurë, më duhej të kthehem në shtëpi, në Korçë, dhe të kërkonj Drejtësi të Drejtë së këtejmi. Po e kërkonj Drejtësinë në

⁹⁹ Pandeli Kotoko: Metropolit i Gjirokastrës që prej vitit 1937-1941, me origjinë nga Korça, i larguar si fanariot dhe i rrëzuar nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Shqiptare.

Shqipëri, më parë, dhe pastaj, po qe se s'e gjenj dot këtu, po e kërkonj në Beograd, në Bukuresht dhe në Athinë.”

Pas kthjellimit, i jep subjeksionin e pyetjes që ngjan së tepërmi me një akuzë të “papërmetuar prej moralit...”, sepse tertherjen e tij ia kishin dhënë "shokëve" studiues në Beograd:

“- i hodhe ndë pus, apo i përcolle nuk di se ku, në dorë të ndonjë profesori Ballkanas djalosh, nga ata që gjuajnë të afishohen me suksese letrare të lehta, domethënë të përdomjen djersën edhe mundin e tjetrit, lark Vendit të tyre ... “

Mendon 60-vjeçari Qafëzezi se do ta gjejë të drejtën edhe sepse ka miqësi me ‘Shokët e mij’ Dhimitri & Koçi Xoxe (ky i fundit asokohe ishte figurë e parë qendrore e shtetit njëpartiak), por edhe se ka dokumentin mbi materialet e dorëzuara për botim te gazeta “Bashkimi”, ku redaktor ishte Shefqet Musaraj:

“Nga një dokument i Redaksisë së "Bashkimit" më rezullton se Dorëshkrimet e mij janë marë në mest të ditëvet 6-10 Shtator 1945, kur - thotë dokumenti - ishin vënë në udhë botimi, me një çpërblim-ndihmë letrare të ofruar bujarisht prej Shtabit të Fletores "për të ndihmuar Xha Ilon" 60-vjeçarin - më nuk më jet tjetër udhë vëçse të rënkonem zyrtarisht në dy Zyra: Pleqësisë së lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë edhe Shokëvet të mij Dhimitri & Koçi Xoxe (Babë e Bir).” (Ndoja, Leka. 2013: 100)

Në atë kohë mundet ka të drejtë të ndihet i sigurtë në vetvete, sepse jo vetëm që zyrtarisht ka siguruar reputacion kombëtar dhe ka njohje edhe me institucionet akademike të vendeve fqinje, por duhet të ketë pasur miqësi personale edhe me vetë Spirun (edhe ky ka qenë vllah, ashtu si edhe Xoxe, kur dihet që Qafëzezi ishte vllah nga nëna):

“Po nuk gjeta dot këtu Drejtësi, po e çonj çështjen në Akademitë Beograd, Bukuresht ett. ku jam i njohtur më mirë nga çdo tjetër shkrimtar Arbinesh-Armën.

Punimet e shkrimtarit nuk mundën të botohen veçse atje tek i destinon i-zoti i tyre.

I padrejtësuemi prej Teje, Shoku Yt (Ilo Mitkë Qafëzezi). (Qafëzezi, Ilo Mitkë: AQSH, F. 426, D. 4, fl. 16.)

Kështu do të vijonte jo rastësisht t’i zhbëhej ndihmesa (jo vepra) dhe për të si hulumtues i suksesshëm dhe jo më si prijës intelektual nuk do të kujtohej më kush, deri sa i veshur me harrim u shua në qytetin e vet. Qafzezi nuk e kuptoi kohën ideologjike, ndoshta formimi që kishte apo mosha, por sistemi totalitar nuk mund ta mbante pranë akademikun, personalitetin që punoi pa kursim për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, kur propagandohej internacionalizmi proletar dhe po përgatitej të vendosej antiteizmi zyrtar (jo ateizmi).

Edhe këtë hap shkatërrues e nxitën dhe e realizuan burrat dhe jo prijësat, prandaj zgjedh të citoj Cristopher Morley, sipas të cilit:

“Life is a foreign language: all men mispronounce it.” (Jeta është një gjuhë e huaj: të gjithë burrat e shqiptojnë gabim.)

BIBLIOGRAFI

Arkivi i Institutit të Historisë së Republikës së Shqipërisë, Tiranë. Fondi: *Ilo Mitko Qafëzezi*, D. 14, fl. 26, fashikuj copë 50.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës-Fakulteti i Studimeve Islame. (2006) *Terminologjia Islame*, Prishtinë.

Basha, Ali Musa. (1996) *Përkthimet e hershme të Kur'anit dhe kritikë për to*; Drita Islame, nr. 23-24, Tiranë.

Berishaj, Anton. (2014) *Religion and Politics in Kosovo*, in Gorana Ognjenović and Jasna Jozelić eds. *Politicization of Religion, the Power of State, Nation, and Faith: The Case of Former Yugoslavia and its Successor States*, New York: Palgrave Macmillan.

Clayer, Nathalie. (2012) *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë, Botime Përpjekja.

Della, Rocca, Roberto Morozzo. (1994) *Kombësia dhe Feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë.

Dizdari, Tair. (2004) *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë.

Fischer, Bernd J. (2005) *A Brief Historical Overview of the Development of Albanian Nationalism*, Presented at East European Studies center discussion on March 23, Washington D.C.

Gewehr, Wesley M. (1931) *The Rise of Nationalism in the Balkans, 1800-1930*. New York: H. Holt and Company.

Hysa, Mahmud. (2000) *Alamiada shqiptare II*, Logos-A, Shkup.

Hysi, Shyqyri. (2007) *Rauf Fico-shtetar dhe diplomat i shquar* (monografi), Tiranë.

Ismaili, Elez. (2016) *Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe*, Zëri Islam.

Jusufović, Azmir. (2019) *Ilo Mitko Qafëzezi dhe përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në shqip*, "Zani i Naltë", shtator, f. 31.

Kaleshi, Hasan. (1976) *Roli i shqiptarëve në Letërsinë Orientale*, Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huajt, Prishtinë.

Karić, Enes. (2005) *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, f. 50.

Krasniqi, Memli. (2013) *Shoqëria biblike britanike për të huajt dhe bektashizmi (1814-1897)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

KURA'NI (KËNDIMI) (1921) PËRKTHYER SHQIP PREJ I.M.Q., SHTYPUR NDË RUMANI.

- Lloshi, Xhevat. (2005) *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Tiranë.
- Mehdiu, Feti. (1996) *Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*, Logos-A, Shkup.
- Morina, Qemajl. (2003) *Identiteti fetar i shqiptarëve në: Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar*, Shoqata Kulturore “Zëri Ynë”, Zëri Ynë, Prishtinë, f. 25-31.
- Ndoja, Leka. (2013) *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri (1944-1990)* Studim, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë.
- Ombashi, Rahim. (2002) *Po vjen Noli...*, Kotti, Korçë.
- Ombashi, Rahim. (2020) *Historik i shtypit periodik shqiptar (Sprovë për një poetikë historike)*, Tiranë.
- Qafëzezi, Ilo Mitkë. (1936) *Dhaskal Gjoka apo Shkolla Korçare e qemoçme*, Korçë.
- Qafëzezi, Ilo Mitke: AQSH, F. 426, D. 4, fl. 16.
- Rexhepi, Baba. (2006) *Mistiçizma Islame dhe Bektashizmi*, Tiranë.
- Shehu, Hajri. (2006) *Një përkthim i Kuranit i vitit 1921 në gjuhën shqipe*, PERLA, Viti XI, Nr. 2 (41), Botuesi: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë: 85-92.
- Shkodra, Ramadan. (2005) *Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor “Kurani tek shqiptarët”*, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës më 26-27 dhjetor, Prishtinë.
- Tërnavë, Naim. (1991) *Imam Vehbi Ismaili publicist dhe veprimtar i shquar*; Dituria Islame nr. 29, Prishtinë.
- Ambrosiano, Leonardo. (2016) *Mind the (Unbridgeable) Gaps: A Cautionary Tale about Pseudoscientific Distortions and Scientific Misconceptions in the Study of Religion*. Method & Theory in the Study of Religion; Vol. 28, No. 2, pp. 141-225 (85 pages); Published By: Brill <https://www.jstor.org/stable/43907228>
- Peyrefitte, Alain. (1976) *Le Mal Français* (E keqja franceze-French Evil), Paris: Plan, f. 524.
- Le Mal Français* (French Evil) By Alain Peyrefitte Paris: Plan, 1976, 524 p.
- A book that provoked spirited opposition in France when it appeared some months ago. The author, who has distinguished himself a politician and diplomat, argues that France has become weak and pale, has lost her drive

and initiative, has ceased to function effectively- and through no fault but her own. He attributes her decline to the centralization and bureaucratization of state and society, an argument which is not rarely been advanced so passionately and incisively.

Kimmich, C. (1977). *Foreign Affairs*, (4), 912-912. doi: 10.2307/20039775

Demjaha, Agon & Peci, Lulzim. (2016) *What happened to Kosovo Albanians: The impact of religion on the ethnic identity in the state building-period*; KIPRED, POLICY PAPER No. 1/16 – June, Prishtina, Kosovo. <http://www.kipred.org/>

Miranda PILA¹⁰⁰

ELBASANI LIBRARY "QEMAL BAHOLLI", AN IMPORTANT PART OF THE ELBASAN LITERARY CORPUS

Abstract

When we talk about the Literary Corpus we cannot stay without mentioning the Library as an important and vital part of it. This scientific publication gives a short history of the Public Library of the city of Elbasan "Qemal Baholli", shows the history and reason for the formation of this library and its operation over the years. Special attention is paid to the life of Qemal Baholli, whose name the Library bears and the charitable work done by the Baholli family by building this academic institution for the city of Elbasan. This Library is ranked among the richest Libraries in the country in terms of wealth and is a public institution in the service of cultural development of Elbasan. Special attention is paid to the service, automation, enrichment of the library over the years and the ways of this enrichment as well as the international connections that this Library has.

Keywords: *literary corpus, library, Qemal Baholli, Elbasan*

¹⁰⁰ "A. XHUVANI" University
Faculty of Humanities
Department of english and german languages
E-mail:mirapila@yahoo.com

Abstrakt

Kur flasim për korpus letrar nuk mund të rrimë pa përmendur bibliotekën, si një pjesë e rëndësishme dhe vitale e tij. Ky botim shkencor jep një histori të shkurtër të Bibliotekës Publike të qytetit të Elbasanit “Qemal Baholli”, tregon historinë dhe arsyen e formimit të kësaj biblioteke dhe funksionimit të saj ndër vite. Vëmendje e veçantë i kushtohet jetës së Qemal Bahollit, emrin e të cilit mban Biblioteka dhe veprën bamirëse që bëri familja Baholli, duke ndërtuar këtë institucion akademik për qytetin e Elbasanit. Kjo Bibliotekë radhitet ndër bibliotekat më të pasura të vendit për nga pasuria që zotëron dhe është një institucion publik në shërbim të zhvillimit kulturor të Elbasanit. Vëmendje e veçantë i kushtohet shërbimit, automatizimit, pasurimit të bibliotekës ndër vite, mënyrat e këtij pasurimi si dhe lidhjet internacionale që kjo bibliotekë ka.

Fjalë kyçe: *korpus letrar, bibliotekë, Qemal Baholli, Elbasan*

Libraries as temples of knowledge have walked difficult but beautiful paths. The effort of the Elbasan patriots for a library has been early. It has been a heartfelt effort, love and desire to see the homeland move forward as an equal and among equals towards knowledge, science and progress. Referring to the Elbasan press of the time, we single out the valuable magazine of the years 1918-1919 "Literary Garden": Temporary and monthly: Published by the Literary Region, where each issue calls on the intellectuals and authors of Elbasan for the enrichment of the Regional Library, shows that the efforts of the people of Elbasan for a Regional Library have been great, an effort that does not come from spontaneity, but from the private libraries of patriotic intellectuals educated around the world who returned to their homeland with the most valuable wealth: books. Browsing the oldest periodical of the library of Elbasan makes us proud because it speaks of a great effort to distribute personal books and those that can not be bought and this came precisely from the organized work of Elbasan intellectuals in the late XIX century

and early twentieth century, through patriotic Centers and Societies established for patriotic organization, learning the Albanian language and striving together with all Albanian patriots inside and outside the homeland for the Independence of the Country.

And you see the efforts of the people of Elbasan for the book and the library everywhere in the depths of the centuries, you see them with their efforts for knowledge, development and culture, you see them with the desire for peace and understanding, with the desire for tolerance and civic coexistence, and all this of course has brought only the desire for knowledge and development ... Elbasan intellectuals and patriots walk together with all Albanian patriots inside and outside the homeland until they achieved the great goal of Independence and the Albanian State... But the country did not lack people with great spirit that their wealth was put in the service of education, culture and development... and one of them was Nazif Baholli, who in honor of his son who loved books, donated a work to his city, Elbasan, culture, The Library, very necessary, to perpetuate the great desire of his son that death cut off life in the flowers of youth youth to bring to place the great desire of Qemal Baholli for books and to make him immortal remembering him even today...¹⁰¹

PUBLIC LIBRARY OF ELBASAN CITY "QEMAL BAHOLLI"

Public library, charity work of Nazif Baholli, well-known owner in Elbasan. In the 1930s, one of his sons Qemali, a former student at the Korça High School, lost his life at a young age. In memory of his son, Nazifi, as a patriot with progressive ideas, had the idea to build a cultural work in Elbasan, a public library, naming it after his son: Qemal Baholli. He bought from the City Hall the land where the building would be erected, with a sum of 800 napoleons of gold. The presidency of the "Club of Intellectuals" of the city publicly thanked Nazif Baholli, for

¹⁰¹ Cankja, Drita. Hatellari, Manjola. (2014) Public Library "Qemal Baholli" and its History: 1934-2014. Onufri Publishing House, Pages 11-13

this act, securing respect and sympathy..." Unfortunately, Nazif died very soon and his work was followed by his two other sons, Hyqmet and Nazmi, who had the full support of the municipality and local authorities. The permission from the Ministry of Education was given by the Minister Mirash Ivanaj himself, appreciating and thanking the noble gesture of the Baholli brothers with a special letter. The press of the time showed enthusiasm for this act.

The laying of the first stone in the foundation was done with a special ceremony, with speeches by the teacher V. Llapushi, Mir Papajani, student Qamil Xhaja. The latter appealed to the patriotism, generosity of the rich of the country, reminding them of the sacred duty not to forget the people with whom they had grown, lived and among whom they had become rich. After a period of two years, the building with a green environment was ready. The Baholli brothers also made available 2000 francs for the purchase of books. Books were also donated by various intellectuals of the city, foreign embassies in our country and especially the Royal Court. 1000 volumes were initially introduced in its funds.

The inauguration party was organized on July 21, 1935. The library was handed over to the Municipality, becoming a public institution in the service of the cultural development of Elbasan. The first director was the intellectual Ibrahim Laçi. Its council, or as it was called at that time, the commission of B.P.Q.(Public Library "Qemal Baholli", was chaired by the mayor A. Dilaveri, with the chairmanship consisting of: Lef Nosi, Beqir Rusi, Tasim Myftiu, Hyqmet Baholli and Ibrahim Laçi. The Council of B. P.Q. provided income with the help of various donors, prominent Albanian intellectuals, at home and abroad.

In addition to enriching with books, B.P.Q. increased every year the service to the readers of the city and the number of its activities. With suitable facilities and conditions, readers requested more reading time in the library. Later in the B.P.Q. Museum objects were also placed in a special fund hall and after 1936, the "Qemal Baholli Library and Museum was named as an institution.

At the beginning of the XXI century the library still bears the name "Q. Baholli ". It ranks among the richest libraries in the country in terms of wealth. After 1945, its fund was enriched with the Albanological and

Balkanological library, owned by Lef Nosi. It is famous not only for its rare works but also for the fund collections of the periodical of the period before the Second World War. B.P.Q. counts about 200,000 books and periodical collections in Albanian and foreign languages. The Fund of Albanology, Balkanology, the periodical before the Second World War counts over 15,000 valuable periodical books and collections.¹⁰²

CATALOGS AND CLASSIFICATION

In the Public Library "Qemal Baholli" have entered in its funds about 200 000 volumes of books and periodicals since its establishment Of these about 135 714 are Albanian publications, about 23 756 are publications in foreign languages and 6 913 periodical collections. This library is ranked among the richest libraries of our country with Orientalist literature and the fund with Albano-Balkanological values.

All literature in the library has undergone technical-library processing, and the relevant catalogs have been set up, which reflects the bibliographic description in the file for the material which is made according to current standards of bibliographic description. The basis of the library classification is the Universal December Classification (KDU) (Klasifikimi Dhjetor Universal) which has been used since 1968 onwards. It is worth mentioning that the foundations of the modern library with its files were made by its former director Mr. Rescue Karaj. Today, in the age of cybernetics and the modern Internet, in order to serve users as quickly as possible, an electronic file has been put into service, which dates back to 2006. To help readers, relevant catalogs have been compiled for all the literature available in the library.

The catalogs are:

¹⁰² ELBASANI-ENCYCLOPEDIA/ Head Editor Kujtim Bevapi. Elbasan: SEJKO, 2004. Pages 56-58

1. Alphabetical catalog in Albanian language.
2. Systematic catalog in Albanian language.
3. Alphabetical catalog in foreign languages.
4. Systematic catalog in foreign languages.
5. Alphabetical and systematic catalog of Albanology.
6. Alphabetical and systematic catalog of the Provincial File.
7. Catalog of the Albanian Periodical.
a-Before 1944 (alphabetical, systematic)
B-After 1945 onwards... (Alphabetical and systematic)
8. Foreign Periodical Catalog.
9. Topographic catalog (alphabetical, systematic)

LIBRARY FUNCTIONS

The Public Library "Qemal Baholli" is the first institutional building in the Albanian State, currently a library institution, the main cultural center of the community and an important research center of scientific research. Its activities are based on the Law on Libraries of Albania, approved by the Parliament in February 2000. The Public Library has the status of an important Cultural Institution that depends on the local government.

Its task is to preserve and collect the written cultural heritage of the Albanian people in general and the Elbasan community in particular. It is also tasked with gathering information and passing it on to future generations. This function of libraries is best seen in the saying: "Public Libraries are the memories of communities, while National Libraries are the memories and identities of nations."

The library has a dual character, scientific and public.

It is:

1. Center for storage and preservation of Albanian publications.
2. The main bibliographic center of the community.

3. Study center in the field of library and information science for school libraries and the district library.
4. Center for library education and professional community training.
5. Cataloging center in the publication of books in the community of Elbasan.
6. Albano-Balkanological fund service center.
7. Free access to fast internet information for all users without distinction.
8. Center for digitization of rare values.

LIBRARY ORGANIZATION

The library has its director who organizes, controls the work and manages the library. Under this management is the library staff with 13 full time employees. The library sectors are:

1. Directory
2. Sector of enrichment, classification, cataloging and bibliography, database entry, qualification, training for the Region of Elbasan, drafting the basic manual file.
3. Sector of Albanology, careful service of this fund, maintenance of the file of Albanology, integration of the file of the book of Albanology in the file, processing of the coherent periodical.
4. Adult service sector (book and periodical).
5. Child service sector.
6. Information Sector (Maintenance of alphabetical and systematic files, Albanian and foreign as well as regional files).

COLLECTIONS OF BOOKS AND OTHER MATERIALS

In the library funds are found early editions of books starting from 1500 in Latin, French, Arabic, Turkish, etc. to the present day.

QUANTITY IN VOLUMES AND COLLECTIONS

1. Albanian book fund, 135 714 copies
2. Foreign book fund, 223 756 copies
3. Fund of Albano-Balkanology, 5161 copies
4. Old Periodical Fund, 909 collections
5. Coherent Periodical Fund, 5022 collections
6. Foreign Periodical Fund, 1606 collections
7. Children's book fund, 22 156 copies
8. Fund of books donated in Albanian, 3023 copies
9. Fund of books donated in foreign languages, 274 copies
10. Antiques, 200 copies
11. Map, 15 maps
12. Materials not books, 27 pieces

SERVISING

The library "Qemal Baholli" is attended by more than 10,000 visitors per year and by tens of hundreds of visitors, who are given for circulation about 135,000 books and periodical collections per year. Every day 250-300 readers enter the library hall.

ENLARGEMENT OF THE LIBRARY BY YEARS

The enrichment of the library is realized through:

1. Purchase
2. PRESENTS
3. VARIOUS DONATIONS
4. LIBRARY EXCHANGES (INSIDE AND ABROAD)

One of the main tasks of working in the library is the systematic enrichment of the fund. The more materials available the more readers

come to the library and the more the membership of the users increases. Most of the book materials in the library are obtained through purchases according to the fund allocated by the Municipality. These purchases are made rhythmically and systematically by pulling the top titles based on user requirements. For this purpose the library is connected with the city libraries as well as with some publishing houses. The District Council has also provided great assistance in purchasing new publications.

Another very important form of library enrichment is gifts. Initially, the library funds included 1000 books donated by the Royal Court as well as by many patriots, intellectuals of that time who are reflected in the early periodical of the time, such as: Nosi family, Vasil Llapushi, Baholli family and many others.

Today we will respectfully mention the patriots, intellectuals, book lovers, patriotic families from Elbasan or from Albania, wherever they are even outside the borders, who donate books to the library from time to time.

We also have gifts from Foundations, Associations and various Embassies such as: Iranian, French, American, British, Italian Embassies, etc. The Soros Foundation has donated new rubric books in English.

INTERNATIONAL LINKS

The Library of Elbasan has very good cooperation and exchange relations with many libraries in the world. There is a regular correspondence with them as a result of a work, of a tradition since its establishment. Here are some:

1. With the Inter-Municipal Library of Prizren
2. With the Bar Library of Italy
3. With the National Library of Germany
4. With the Oxford Library of England which invites us every year to take part in the big workshop held in Birmingham on World Book Day, where some of the library staff went and it was an impressive experience
5. With the Main Library of Utah in America

6. With the Egyptian Embassy
 7. With the French Embassy
 8. With the Iranian Embassy
 9. With various Associations and Foundations
 10. Many private people living in different parts of the world have also helped the Library
 11. With the National Library of Sofia, Bulgaria
 12. Very good cooperation with the GËTE Institute in Belgrade
- We hope that in the future we will have more connections with other countries for the benefit of enrichment and service as well as the exchange of experiences.

AUTOMATION

Library automation today is a process dictated by time and without it there can be no interlibrary links and access to everything that Albanian communities need. Today in the library of Elbasan an effort is being made to achieve what the community needs today, information as fast as possible through digitalization.¹⁰³

¹⁰³ Guide: Public Library “Qemal Baholli”. Elbasan. (2014) Library Literary Staff. Onufri Publishing House. Pages 11-30

BIBLIOGRAPHY

- 1- Cankja, Drita. & Hatellari, Manjola. Public Library "Qemal Baholli" and its History: 1934-2014. Onufri Publishing House, 2014. Pages 11-13.
- 2- ELBASANI-ENCYCLOPEDIA /Head Editor.Kujtim Bevapi. ELBASAN: SEJKO, 2004. Pages 56-58.
- 3- Guide: Public Library "Qemal Baholli" Elbasan. Library Literary Staff. Onufri Publishing House. 2014, Pages 11-30.
- 4- Cankja, Drita. Hatellari,Manjola. Biblioteka Publike “Qemal Baholli” dhe Historia e Saj: 1934-2014. Shtëpia Botuese Onufri, 2014. Fq 11-13.
- 5- ELBASANI-ENCIKLOPEDI /k/red. Kujtim Bevapi. ELBASAN: SEJKO, 2004. Fq 56-58.
- 6- Guidë: Biblioteka Publike “Qemal Baholli” Elbasan. Stafi Letrar i Bibliotekës. Shtëpia Botuese Onufri. 2014, Fq 11-30.



UNIVERSITY COLLEGE
BEDER

Address

"Jordan Misja" St, Tirana - Albania

Contact: Tel: + 355 4 24 19 222

www.beder.edu.al, e-mail: bjh@beder.edu.al

